



Fëmijë në fshatin Trebisht.
Foto: Aleksandër A. Novik, v. 2010

Redaktorë: Andrea N. Sobolev dhe Aleksandër A. Novik

Gollobordë (Golo Bordo), Shqipëri

Nga materialet
e ekspeditës ballkanike
të AShR-së dhe UShSt-P-së në vitet 2008—2010

“NAUKA” Sankt-Peterburg

BOTIMET TOENA
Tiranë, 2017

AKADEMIA E SHKENCAVE E RUSISË
Instituti i Studimeve Linguistike
Muzeu i Antropologjisë dhe i Etnografisë “Pjetri i Madh”
(Kunstkamera)

UNIVERSITETI SHTETËROR
I SANKT-PETERBURGUT
Fakulteti Filologjik

Gollobordë (Golo Bordo), Shqipëri

Nga materialet
e ekspeditës ballkanike
të AShR-së dhe UShSt-P-së në vitet 2008—2010

Redaktorë:
Andrea N. Sobolev dhe Aleksandër A. Novik
(në bashkëpunim me Maria S. Morozovën)

“NAUKA” Sankt-Peterburg

BOTIMET TOENA
Tiranë, 2017

Përkthim i botimit në rusisht:

Голо Бордо (Gollobordë), Албания. Из материалов балканской экспедиции РАН и СПбГУ 2008—2010 гг. / Под редакцией Андрея Н. Соболева и Александра А. Новика. — Санкт-Петербург: Наука; München: Verlag Otto Sagner, 2013. 272 стр.; илл. [19,1 усл. печ. л.]. (Materialien zum Südosteuropasprachatlas / Herausgegeben von Helmut Schaller und Andrej Sobolev. Band 6). ISBN 978-5-02-038322-7 («Наука»); ISBN 978-3-86688-224-9 (Verlag Otto Sagner).

Është përkthyer në shqip nga
Ligor Cullufe

Recensentë

Kandidate e shkencave filologjike Z. K. Shanova (UShSt-P)

Kandidat i shkencave filologjike M. L. Kisilier (UShSt-P dhe ISL ASHR)

Kandidate e shkencave historike N. G. Gollant (MAE ASHR)

Ekspeditat, punimet dhe botimi i kësaj monografie kolektive janë realizuar me ndihmën e granteve të akorduara nga Fondi Shkencor Shtetëror Rus (FShShR): projekti № 09-04-18033e “Dialektet e gjuhëve ballkanike në zonat e kontaktit: ekspedita dhe studime eksperimental-laboratorike”; projekti № 11-04-18009e “Dialektet e gjuhëve ballkanike në zonat e kontaktit: ekspedita dhe studime eksperimental-laboratorike”; projekti №12-04-00232a “Dialektet e gjuhëve ballkanike në zonat e kontaktit”, dhe nga Programi i studimeve themelore të Presidiumit të ASHR-së “Traditat dhe risitë në histori dhe në kulturë — Tekstet e kulturës tradicionale në perspektivën e evolucionit kulturor”, projekt i vitit 2012 “Format jostandarde të gjuhës si kod kulturor në Ballkan — Tekstet dhe llojet e tyre”. Përkthimi në gjuhën shqipe dhe botimi u realizuan me mbështetjen financiare të grantit të Fondit Shkencor Rus (projekti № 14-18-01405 “Nga separacioni deri në simbiozën: gjuhët dhe kulturat e Europës Juglindore në kontakt”).

Udhëheqës i projektit
Andrea Nikollajeviq Sobolev

Në kopertinën e librit është përdorur fotoja e Xhulia Sadikut, e bija e Ramazanit dhe e Fatima Sadikut, me veshjet tradicionale në dasmë. Fshati Trebisht. Foto: Aleksandër A. Novik, v. 2009.

Është përdorur harta bullgare e pjesës jugore të krahinës së Dibrës dhe Gollobordës në gjysmën e parë të shekullit XX.

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo
Redaktore: Tianda Kaçi, Besa Vila
Përkujdesja grafike: Elida Stafa
Kopertina: Albana Kura Gega

ISBN 978-5-02-038444-6 ("Nauka")

ISBN 978-9928-235-53-4 ("Toena")

© Kolektiv autorësh, 2017

© Botimet Toena, 2017

© "Nauka", 2017

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjete apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollesha", K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116

E-mail: redaksia@toena.com.al

botimet.toena@gmail.com

[Http://www.toena.com.al](http://www.toena.com.al)

Издатель: Санкт-Петербургский филиал ФГУП «Издательство «Наука»
199034, Санкт-Петербург, 9 линия, 12

Адрес для корреспонденции: 199034, Санкт-Петербург, Менделеевская
линия, 1

main@nauka.nw.ru

naukaspb.com

TË DHËNA PËR AUTORËT

Domosileckaja Marina Valentinovna, kandidate e shkencave filologjike, bashkëpunëto e vjetër shkencore ISL AShR.

Dugushina Aleksandra Sergejevna, kandidate e shkencave historike, MAE (Kunstkamera) AShR.

Ermolin Denis Sergejeviç, kandidat i shkencave historike, bashkëpunëtor i ri shkencor MAE (Kunstkamera) AShR.

Kollosova Valeria Borisovna, kandidate e shkencave filologjike, bashkëpunëto e vjetër shkencore ISL AShR.

Morozova Maria Sergejevna, kandidate e shkencave filologjike, bashkëpunëtoe shkencore ISL AShR; asistente në katedrën e gjuhësisë së përgjithshme të Fakultetit Filologjik të UShSt-P-së.

Novik Aleksandër Aleksandroviç, kandidat i shkencave historike, shef i sektorit të europaistikës MAE (Kunstkamera), AShR; docent në katedrën e gjuhësisë së përgjithshme të Fakultetit Filologjik të UShSt-P-së.

Rusakov Aleksandër Jurjeviç, doktor i shkencave filologjike, bashkëpunëtor i lartë shkencor ISL AShR; profesor në katedrën e gjuhësisë së përgjithshme të Fakultetit Filologjik të UShSt-P-së.

Sobolev Andrea Nikollajeviç, doktor i shkencave filologjike, bashkëpunëtor i lartë shkencor ISL AShR; profesor në katedrën e filologjisë sllave të Fakultetit Filologjik të UShSt-P-së, profesor në katedrën e gjuhësisë së përgjithshme të Fakultetit Filologjik të UShSt-P-së; profesor i jashtëm i Universitetit të Marburgut, Gjermani.

PËRMBAJTJA

TË DHËNA PËR AUTORËT	13
HYRJE	17
TË DHËNA PËR EKSPEDITËN DHE MONOGRAFINË KOLEKTIVE: OBJEKTIVAT, PROGRAMET, KRONIKA E PUNIMEVE, PJESËMARRËSIT <i>Andrea N. Sobolev, Aleksandër A. Novik</i>	17
BALLKANI PERËNDIMOR: MIKRORAJONET KUFITARE DIBËR DHE GOLLOBORDË <i>Andrea N. Sobolev</i>	29
SLLAVËT DHE SHQIPTARËT, MYSLIMANËT DHE ORTODOKSËT NË GOLLOBORDË <i>Andrea N. Sobolev</i>	45
FSHATRAT E MARRA NË STUDIM <i>Andrea N. Sobolev</i>	51
SLLAVËT E GOLLOBORDËS GJUHA FONETIKA DHE GRAMATIKA <i>Andrea N. Sobolev</i>	57

LEKSIKU

Vëzhgime të përgjithshme mbi leksikun dhe frazeologjinë

Andrea N. Sobolev..... 79

Terminologjia e blegtorisë

Andrea N. Sobolev..... 90

Sistemi i termave të farefisnisë dhe etiketa familjare

Maria S. Morozova 102

Fitonimia

Marina V. Domosileckaja, Valeria B. Kollosova, Andrea N. Sobolev..... 132

KULTURA TRADICIONALE

VROJTIME MBI KULTURËN MATERIALE

Aleksandër A. Novik..... 141

KULTURA SHPIRTËRORE

Andrea N. Sobolev..... 154

RITET GJATË JETËS SË NJERIUT

Rituali i lindjes

Aleksandra S. Dugushina, Maria S. Morozova..... 171

Rituali mortor-përkujtimor dhe kultura e varrimit

Denis S. Ermolin 186

VËZHGIME MBI SUBKULTURËN FEMËRORE

Aleksandra S. Dugushina, Maria S. Morozova..... 198

ÇËSHTJE TË IDENTITETIT

Aleksandër A. Novik..... 206

TEKSTE FOLKLORIKE

Andrea N. Sobolev..... 212

TEKSTE DIALEKTORE	
<i>Andrea N. Sobolev</i>	216
SHQIPTARËT E GOLLOBORDËS	
GJUHA	
<i>Aleksandër Ju. Rusakov</i>	249
TEKST DIALEKTOR	
<i>Aleksandër Ju. Rusakov</i>	262
ARKIVIMI DHE RUAJTJA NË MUZE E MATERIALEVE	
TË EKSPEDITAVE	
<i>Aleksandër A. Novik</i>	263
SHTOJCË	275
LISTA E MATERIALEVE TË TERRENIT,	
QË RUHEN NË MAE (KUNSTKAMERA) ASHR	
<i>Denis S. Ermolin</i>	275
BIBLIOGRAFIA.....	283
BOTIMET E AUTORËVE TË MONOGRAFISË KOLEKTIVE	
NË BAZË TË MATERIALEVE TË EKSPEDITËS.....	302
LISTA E ILUSTRIMEVE.....	307

HYRJE

TË DHËNA PËR EKSPEDITËN DHE MONOGRAFINË KOLEKTIVE: OBJEKTIVAT, PROGRAMET, KRONIKA E PUNIMEVE, PJESËMARRËSIT

Andrea N. Sobolev, Aleksandër A. Novik

Problemi themelor i shkencës mbi gjuhët dhe kulturat e popujve të gadishullit të Ballkanit (gjuhësisë ballkanike dhe antropologjisë kulturore ballkanike) konsiston në faktin se ende nuk është zgjidhur çështja e proceseve të afrimit dhe të veçimit kulturor e gjuhësor, për Euroazinë në përgjithësi dhe Ballkanin në veçanti, njohja e të cilave vlen për të krijuar një përfytyrim shkencor mbi shoqëritë shumëkulturëshe dhe shumëgjuhëshe, të dikurshme ose bashkëkohore. Ballkanistët petërburgas të Institutit të Studimeve Linguistike të Akademisë së Shkencave të Rusisë (ISL ASHR), specialistët e Muzeut të Antropologjisë dhe Etnografisë “Pjetri i Madh” (Kunstkamera) pranë ASHR-së (MAE ASHR) dhe të Fakultetit Filologjik të Universitetit Shtetëror të Sankt-Peterburgut që nga fillimi i viteve 1990 (së pari në kuadrin e projektit shkencor ndërkombëtar “Atlasi i vogël dialektologjik i gjuhëve ballkanike” (AVDGjB) / “Малый диалектологический атлас балканских языков” (МДАБЯ) / “Kleiner Balkansprachatlas” (KBSA)) e kanë përqendruar vëmendjen e tyre te studimi i shumanshëm

i grupit të gjuhëve dhe kulturave ballkanike konvergjuese në nivelin e dialekteve territoriale dhe varianteve vendore të kulturave, duke futur në qerthullin e botimeve shkencore materiale me strukturë sistemore, tërësisht të reja dhe autentike, të grumbulluara drejtpërdrejt nga terreni në përputhje me programe të përpunuara posaçërisht për këtë qëllim [Плотникова1996; Домосилецкая и др. 1997; Соколов и др. 1997; Новик 2009 (dorëshkrim); Соколов 2009 (dorëshkrim); Колосова, Домосилецкая 2010 (dorëshkrim)]. Falë kësaj veprimtarie shumëvjeçare janë krijuar, po përpunohen dhe po plotësohen në vijimësi fonde arkivore me tekste, me fotografi, dhe me materiale dëgjimore e pamore për gjuhët dhe për kulturat ballkanike [Arkivi i AVDGjB 1995—2013; Arkivi i MAE; Arkivi i sektorit të europaistikës MAE], janë hedhur themelet e mbledhjes së objekteve të kulturës popullore dhe krijimit të bazës kompjuterike të të dhënave në MAE (Kunstkamera) AShR, si edhe po publikohen një seri botimesh brenda dhe jashtë vendit.

Gadishulli i Ballkanit ka qenë dhe mbetet një rajon i rëndësishëm nga pikëpamja strategjike për Perandorinë Ruse, BRSS-në dhe Federatën Ruse, e megjithatë shkenca jonë në tërësi dhe vazhdimisht është dalluar dhe dallohet për një qasje të paanshme, objektive dhe të mbështetur fort në fakte ndaj problematikës së tij. Për këtë ka ndihmuar edhe fakti që ajo ka grumbulluar një përvojë të rrallë për mbledhjen e materialit të besueshëm në terren, veçanërisht në fushën e gjuhësisë dhe të etnografisë. Ruajtja e kësaj përvoje në vitet 1990 dhe vijimi i hulumtimeve të shumta në terren, në ditët tona, ka sjellë rezultate konkrete, që dallojnë mjaft nga gjykimet e njëanshme teorike (shih p.sh. [Гуськова 2011; Kaplan 1993; Woodward 1995; Holbrooke 1998]).

Të kuptuarit e jetës së njeriut mund të jetë një veprimtari me të vërtetë shkencore vetëm në atë rast kur faktet e jetës, të përfutuara nga hulumtimet, janë të mjaftueshme për këtë qëllim, kur brenda segmentit të përzgjedhur për analizë zbulohen lidhje sistemore mes fakteve të veçuara, kur këto lidhje sistemore zbulohen edhe më gjerë mes segmentit të analizuar dhe botës që e rrethon, në rastin kur kjo

veprimtari mbështetet në inventarizimin e ndryshueshmërisë së fakteve dhe lidhjeve në kohë dhe në hapësirë, dhe si përfundim, kur ajo hedh dritë mbi rolin e segmentit të përzgjedhur në jetë në përgjithësi dhe në verifikimin e shkaqeve të sjelljes së njerëzve dhe grupeve të tyre. Për këtë qëllim, përdorimi i pyetësorëve ka përparësi, pasi nëpërmjet plotësimit të tyre, mund të grumbullohen të dhëna me strukturë sistimore, të cilat janë të krahasueshme si ndërmjet tyre po kështu edhe me ato të natyrave të ngjashme, duke bërë të mundur jo vetëm përshkrimin e plotë dhe sistemor të një kulture konkrete vendase dhe të gjuhës së saj, por edhe përcaktimin e vendit të saj ndërmjet kulturave të tjera në hartën etnografike dhe linguogjeografike të rajonit. Në rastin tonë, për të përcaktuar vendin e kësaj kulture, janë krahasuar të dhënat e mbledhura gjatë punës në terren me të dhënat e “Atlasit dialektologjik të gjuhës shqipe”, “Atlasit dialektologjik maqedonas”, “Atlasit dialektologjik bullgar”, “Atlasit të vogël dialektologjik të gjuhëve ballkanike”, “Atlasit etnologjik të Jugosllavisë”, me të dhënat e arkivave, si dhe të monografive mbi dialektologjinë, etnografinë, kulturologjinë etj. Materialet e reja, që kemi mbledhur, nuk hedhin poshtë vëzhgimet e mëparshme shkencore, por ndërthuren në tablonë e përgjithshme të diskursit shkencor ndërkombëtar, i cili ka për qëllim zbulimin e të vërtetës shkencore.

Hulumtimet në terren të shkencës ruse në zonat e kontaktit në Ballkan, nisin nga Sankt-Peterburgu duke filluar që prej vitit 2008: ISL pranë AShR-së, MAE (Kunstkamera) AShR dhe Universiteti Shtetëror i Sankt-Peterburgut (UShSt-P) po ndërmarrin studime komplekse të rajoneve të Gollobordës,* Gorës, Prespës, Devollit, Korçës, Kolonjës dhe të Dropullit në Shqipëri, si dhe të rajonit të Cakonisë në Greqi; në ekspedita marrin pjesë gjithashtu edhe studentë të UShSt-P-së, si edhe aspirantë të AShR-së. Për shkencën tonë ka rëndësi ruajtja dhe përcimi i përvojës së rrallë në fushën e organizimit dhe të zhvillimit të

* Në botimin rus, toponimet ballkanike jepen në shumicën e kapitujve sipas rregullave të transliterimit nga gjuhët sllave, ndërsa në kapitullin e A. Ju. Rusakovit jepen në gjuhën shqipe.

ekspeditave në Ballkan dhe në territorin e ish-republikave të BRSS-së, si dhe analiza e materialeve, e pasuar më tej me botimin e punimeve të veçanta e përgjithësuese për tematikën e Ballkanit. Nga ana organizative, bashkimi i përpjekjeve të shkencëtarëve, që punojnë në strukturat e AShR-së dhe UShSt-P-së, si dhe angazhimi i specialistëve të rinj, i aspirantëve dhe i studentëve të kurseve të larta në të gjithë ciklin e veprimtarisë, kanë rëndësi të madhe për përgatitjen e kuadrove me kualifikim të lartë shkencor për të ardhmen. Për të hulumtuar zonat me popullsi dygjuhëshe është e domosdoshme që, përveç kualifikimeve të tjera, të zotërohen të paktën edhe këto dy gjuhë ballkanike, dhe për këtë arsye përgatitja e specialistëve të këtij drejtimi kërkon mund e kohë. Përfshirja, në këtë libër, e punimeve të studiuesve të rinj është tregues i fryteve të kësaj pune shumëvjeçare.

Studimi i gjithanshëm, me drejtim antropologjik, i zonave të konvergencës, ka si objekt të vet gjuhët dhe dialektet, kulturën e sigurimit të jetesës dhe punët e ekonomisë shtëpiake, besimet, identitetin etnik dhe vetëdijen e përkatësisë së popullsisë, marrëdhëniet familjare dhe martesore, socializimin e grave në kushtet e shoqërisë shumëfetare dhe polietnike, folklorin, traditat, mitologjinë, sinkretizmin e besimeve dhe drejtimeve të kultit, mekanizmat e përfshirjes së risive në pikturën imagologjike të botës së jashtme, sintezën gjuhësore dhe kulturore në kushtet e kontakteve ndëretnike, ndikimeve gjuhësore, kulturore dhe të jetës së përditshme, huazimeve etj. Ndryshe nga Atlasi i vogël dialektologjik i gjuhëve ballkanike (AVDGjB), që u botua në vitet 1990, ku synohej përfshirja dhe shpjegimi i një materiali sa më të madh, që të ishte tërësisht i përputhshëm në planin ndërgjuhësor dhe kulturor, i mbledhur në një numër fare të vogël të dialekteve më përfaqësuese të gjuhëve ballkanike jashtë zonave të sotme të kontakteve etnike dhe gjuhësore, ekspeditat e reja ballkanike të AShR-së, të nisura nga viti 2008, janë kryer pikërisht atje ku vihet re një bashkëveprim i ngushtë dhe i dendur ndëretnik dhe gjuhësor dhe krijohen grupe të vogla etnike të veçanta (shih [Соколов, Русаков 2005]), ndërkohë që riformatimi i hartës së vjetër dialektore, kulturës tradicionale dhe strukturës etnike, ndryshon me ritme të përshpejtuara. Teorikisht mund të mendohet se

proceset e bashkëveprimit të sllavëve dhe shqiptarëve në Shqipërinë Lindore dhe Maqedoninë Perëndimore, të shqiptarëve dhe arumunëve në Shqipërinë e Jugut, të grekëve dhe shqiptarëve në Epir (Shqipërinë e Jugut dhe Greqinë Veriperëndimore), të grekëve dhe arumunëve, grekëve dhe sllavëve, arumunëve dhe sllavëve në Greqinë Veriore etj., mund të shërbejnë si model për rindërtimin shkencor të proceseve etnogjuhësore në Mesjetë, në kohën e pasmesjetës dhe në ditët e sotme, si dhe për parashikimin e ecurisë të proceseve të ngjashme në të ardhmen.

Kufiri shqiptaro-maqedonas në të gjithë shtrirjen e tij, prej Kosovës përfshirë atë me Greqinë e Veriut, paraqet një rajon tejet interesant e të rëndësishëm për studime linguistike dhe antropologjike. Kufijtë shtetërorë në Ballkanin Perëndimor u vendosën në shekullin XX pa marrë parasysh tiparet fetare dhe gjuhësore të grupeve të mëdha të popullsisë. Ekspeditat tona gjatë viteve 2008—2010 janë kryer në vendet e banuara në lindje dhe në verilindje të Shqipërisë, në një rajon malor që ndodhet pikërisht në kufi me Republikën e Maqedonisë. Numri i myslimanëve sllavishtfolës në këtë rajon arrin në disa mijë, por shifra e saktë është vështirë të përcaktohet. Këtë të dhënë nuk e saktësoi as regjistrimi i popullsisë, i cili u krye në harkun kohor nga tetori deri më 1 nëntor 2011 (Censusi i popullsisë dhe i banesave 2011), rezultatet e të cilit janë publikuar në vitin 2012. Sipas të dhënave të Institutit të Statistikave të Shqipërisë, popullsia e vendit është 2 821 977 banorë. Pakica maqedonase përbën 0.2% të numrit të përgjithshëm të popullsisë [Censusi 2011; Censusi 2011, INSTAT]. Interesant është fakti se gjuhën maqedonase e kanë quajtur gjuhë amtare 0.16% e popullsisë së vendit, ndonëse jo të gjithë ata që e identifikojnë veten si maqedonas e zotërojnë idiomën, dhe jo të gjithë ata që zotërojnë idiomën e identifikojnë veten si maqedonas (apo sllavë). Rezultatet e regjistrimit shkaktuan diskutime të zjarra në shoqëri: një sërë partish, kryesisht ato të krijuara në bazë të përkatësisë etnike e që kanë si qëllim mbrojtjen e të drejtave të pakicave, si dhe një sërë shoqatash kombëtare, i kritikuan ashpër teknologjitë dhe metodat

e përdorura për regjistrimin e popullsisë dhe përfundimet e tij. Nga ana tjetër, përfaqësuesit e autoriteteve shtetërore ngulin këmbë se të dhënat janë transparente dhe të vërteta.¹

Nuk ka dyshim se në këtë pjesë të Ballkanit Perëndimor, të cilën zakonisht e quajnë Shqipëri Lindore dhe Maqedoni Perëndimor, në të dyja anët e kufirit jetojnë bashkërisht mbartës të gjuhës shqipe, sllave, arumune, turke, dhe pikërisht:

shqiptarët (tradicionalisht myslimanë-sunitë, myslimanë-bektashinj, të krishterë-katolikë dhe të krishterë-ortodoksë);

sllavët (të krishterë-ortodoksë dhe myslimanë-sunitë);

romët (kryesisht myslimanë-sunitë), të cilët vetëm në qytetin e Gostivarit flasin në gjuhën e tyre, ndërsa rëndom flasin në gjuhën e popullsisë mbizotëruese, d.m.th. shqip ose maqedonisht;²

arumunët ose *vllehtë* (të krishterë-ortodoksë) aktualisht në një sasi të papërfillshme gjenden në rajonin e Strugës në Maqedoni;

turqit (myslimanë-sunitë), në rajonin Dibër—Zhupë në Maqedoni.

Përbërja shumëgjuhëshe dhe shumëkonfesionale e popullsisë përcakton kompleksitetin e proceseve kulturore, sociale e gjuhësore që kanë ndodhur këtu në të kaluarën dhe që vijojnë të ndodhin edhe sot. Zhvillimi i rajonit në ditët e sotme dallohet nga mungesa e stabilitetit, që vjen si pasojë e shpërbërjes së ish-Jugosllavisë dhe e ndryshimit të regjimit shoqëror në Shqipëri.

Një nga rajonet, ku haset ndërveprimi kulturor dhe gjuhësor i sllavëve dhe shqiptarëve, i të krishterëve dhe myslimanëve, është Gollobordë / Golo Bordo në Republikën e Shqipërisë, rajoni në të cilin, gjatë viteve 2008—2010, ne zhvilluam hulumtimet tona. Me vendim të qeverisë së Shqipërisë të vitit 2008, një pjesë e Gollobordës është përfshirë në Parkun Kombëtar “Shebenik—Jabllanicë”, me qëllim

¹ Për shembull, në intervistën e hollësishme të ministrit të Inovacionit dhe Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit, Genc Pollos, dhënë kanalisht kryesor kombëtar TVSH më 16 dhjetor 2012.

² E gjithë problematika e shkencës, që merret me studimin e romëve, për fat të keq, nuk qe e mundur të trajtohej prej nesh.

tërheqjen e turistëve vendas e të huaj si dhe përthithjen e investimeve për zhvillimin e ekonomisë së popullsisë vendase.

Qëllimi i ekspeditës sonë në rajone të ndryshme të Ballkanit Perëndimor është mbledhja e një materiali të njaftueshëm dhe të domosdoshëm mbi ndërthurjen etnokulturore, për t'iu përgjigjur pyetjes, nëse mikrorajonet-krahinat (shq. *krahin/ë, -a*; derivat nga sllav. **krajъ*) e hulumtuara janë vende të konvergjencës dhe të sintezës kulturore, gjuhësore dhe etnike në përgjithësi dhe në cilat fusha në veçanti.³ Për shembull, bashkëjetesa e dy besimeve në territorin e kufizuar të Gollobordës, ashtu sikur dëshmon edhe literatura mbi këtë rajon, çon drejt një shkrirjeje të habitshme në rrafshin e besimeve dhe shërbesave të kulteve fetare: në familjet myslimane herë-herë ngjyrosin vezë për Pashkë dhe kremtojnë Krishtlindjen, ndërsa të krishterët marrin pjesë në flijimet me rastin e Kurban Bajramit dhe festojnë Nevruzin. Përshkrimi dhe analiza e tërësisë së ndërlikuar të besimeve dhe pikëpamjeve fetare të shqiptarëve dhe sllavëve, myslimanëve dhe të krishterëve, në kushtet e ndërveprimit shumëshekullor, duhet të ndihmojnë për të kuptuar mekanizmat e hyrjes së risive në tablonë e botëkuptimit të njeriut në Ballkan. Nuk duhet harruar madje, se në Ballkanin Perëndimor, lidhjet e brendshme monokonfesionale ndërmjet mikrorajoneve dhe fshatrave të tyre vijnë të mbeten të dobëta, ndërkohë që në popullsitë fshatare të hulumtuara roli i lidhjeve ndërgjinore, fisnore mbetet tejet i fortë, duke përcaktuar përparësitë në jetë (organizimin e qendrave të banuara, bashkëveprimin ekonomik, zgjedhjen e bashkëshortit/es për martesë etj.).

Ekspeditat tona kanë patur si detyrë kryesore grumbullimin e materialeve linguistike, etnolinguistike, etnografike, historike, folklorike nga vendbanimet e përbashkëta të etnoseve të ndryshme, me qëllim analizën e mëtejshme të tyre. Udhëtimet në terren, të ndërmarra në vitet 2009—2010 nga një grup studiuesish prej pesë vetash, kishin

³ Kontaktet dhe huazimet gjuhësore, kulturore, tregtare dhe të jetës së përditshme shpesh çojnë drejt humbjes së këtyre ose atyre simboleve etnike dhe zëvendësimit të tyre me të reja.

përcaktuar si detyrë maksimale: studimin e shumanshëm të zonës kufitare shqiptaro-sllave, ndërkohë që ekspeditat e shtatorit të vitit 2008 të A. N. Sobolevit dhe A. A. Novikut në fshatrat Klenjë, Trebisht dhe Vërnice synonin vetëm përmbushjen e hapit fillestar — njohjen paraprake me rajonin e shtrirjes së sllavëve myslimanë në verilindje të Shqipërisë, vëzhgimin e praktikave kryesore kulturore dhe të ekonomisë shtëpiake të vendasve, të veshjeve tradicionale dhe shtëpive, përmbledhjen e leksikut që përdoret për veprimtarinë blegtorale tradicionale të rajonit;⁴ filmimin e shembujve të rrëfenjave dialektore. Gjatë ekspeditës u filmuan biseda me barinj, baxhoxhinj, që përgatishnin djathë të bardhë dhe nënprodukte të tjera qumështi, si dhe u regjistruan rrëfime me tematikë mitologjike dhe ngjarjesh të shënuara, për përhapjen e islamit e krishtëritimit në popullsinë vendase.

Në kuadër të projektit të FShShR-së “Dialektet e gjuhëve ballkanike në zonat e kontaktit: ekspedita dhe studime eksperimental-laboratorike”, në dimrin e vitit 2009, A. A. Novik, Je. A. Rezvan dhe A. N. Sobolev filluan punën për hartimin e programeve të hulumtimeve të grupeve etnike myslimane në terrenin ballkanik. Në veçanti u përgatit programi kompleks lidhur me temat “Ritet gjatë jetës së njeriut (ose “Ritet e kalimit”, frëngjisht *Rites de passage*) (lindja, vënia e emrit, bërja synet, dasma, varrimi)”, “Festat myslimane (Mevludi, Ramazan Bajrami, Kurban Bajrami dhe Nevruzi)”, “Kurani dhe lutja (tekstet e shenjta, lutja, larja)”, “Xhamia”, “Ajetet në xhami dhe shtëpi”, “Shenjtorët (kultet e shenjtorëve dhe pelegrinazhet e dobishme për Allahun, vizitat në varreza)”, “Mjekësia popullore dhe magjia”, “Etiketa familjare dhe mondane (vendi i grave në shtëpi, statusi dhe përparësia në shoqëri)”, “Mitologjia (demonologjia e ulët, shenjat)”, “Kalendari”. Një pjesë e programit u zbatua gjatë punës në terren në vitet 2009 dhe 2010.

⁴ Pjesërisht në kuadrin e projektit të Komisionit ballkanik të Akademisë së Shkencave të Austrisë në Vjenë, në themel të të cilit qëndronin punimet tona mbi vëllimin AVDGjB për blegtorinë ballkanike [МДАБЯ 2009].

Ekspedita e vitit 2009 në fshatin Trebisht, në të cilën u përfshinë edhe studiuesit e rinj A. S. Dugushina, D. S. Ermolin dhe M. S. Morozova, iu kushtua tërësisht e plotësisht vetëm hulumtimit të ceremonisë së dasmës. U regjistruan 11 disqe DVD, të cilat fiksojnë etapat e ceremonisë në familjen e dhëndrit; studiuesit mbajtën shënim, në fletoret e punës, të dhënat e vërejtura drejtpërdrejt në terren.

Në vitin 2010 punimet nuk u mbështetën financiarisht nga Fondi Shkencor Shtetëror Rus dhe drejtuesit e grupit iu desh t'i përballonte ato me shpenzimet e veta. Në fshatin Trebisht u regjistrua materiali sipas programeve të hartuara paraprakisht (etnolinguistika dhe etnografia, ritet e dasmës, varrimet dhe lindjes, fitonimia, leksiku i farefisnisë etj.);⁵ u morën intervista edhe në fshatin shqipfolës Borovë. Me kthimin në Sankt-Petërburg filloi puna për përshkrimin e koleksioneve, fondeve arkivore fotografike, audiovizive, ditarëve të mbajtur gjatë ekspeditave, regjistrimin e objekteve dhe dorëzimin e tyre në fondet e MAE ASHR-së (shih Përshkrimi i materialeve të mbledhura në terren, që ruhen në MAE (Kunstkamera) ASHR), si dhe për hartimin e kësaj monografie kolektive. Edhe pse në kuadër të ekspeditave dhe veprimtarisë eksperimental-laboratorike të projekteve të FShShR-së nuk parashikoheshin botime, pjesëmarrësit e projektit publikuan disa punime në bazë të materialeve të ekspeditave (shih më poshtë Bibliografinë dhe Botimet e autorëve të monografisë kolektive në bazë të materialeve të ekspeditës).

Gjatë tre vjetëve të projektit, pjesëtarët e ekspeditës kanë qenë në Gollobordë për 18 ditë pune, dhe ia vlen të theksohet se këto ditë kanë

⁵ Krahaso qasjen diametralisht të kundërt të studiuesve maqedonas të Gollobordës, të cilët kanë hequr dorë jo vetëm nga programet, por edhe nga uniteti metodologjik në punën e grupit, duke i motivuar këto vendime me shkakun se “popullsia vendase ka temat e veta përparësore, të cilat shpesh pasqyrojnë më fuqishëm jetën e saj sesa përsiatjet tona shkencore”, dhe me arsyetimin se publiku, të cilit i përkushtohet puna e tyre, është “opinionit i gjerë shoqëror” [Светиева 2006: 9]. Një qasje e tillë i jep fushëveprimi njohjes joshkencore dhe fshin dallimet ndërmjet diskursit joshkencor dhe atij shkencor, që synon të vërtetën, rregullat e këtij të fundit ne jemi përpjekur t'i ndjekim.

qenë të mbushura me veprimtari mjaft interesante, me takime dhe mbresa të paharrueshme, por edhe me disa vështirësi,⁶ që i ndeshëm për herë të parë gjatë punës në terren. Ndryshe nga ç’ e kishim parashikuar, këto vështirësi nuk u shkaktuan nga dallimet e besimit fetar ndërmjet nesh dhe gollobordasve, por nga dallimet e etiketës së përditshme dhe jetësore ndërmjet studiuesve rusë dhe myslimanëve të Gollobordës. Në veçanti, ishte shumë e sikletshme të përballohej për një kohë të gjatë mungesa e plotë e privatësisë dhe e hapësirës vetjake, një gjë kjo krejt e zakonshme për myslimanët, që jetojnë në familje të mëdha, kur secilin nga ne gjithnjë e gjithkund e shoqëronin anëtarët e familjes që kishte mikpritur ekspeditën tonë, duke na treguar respekt dhe ndihmë si mysafirë të shtëpisë, por faktikisht dhe ndoshta në mënyrë të pavetëdijshme, duke kontrolluar çdo veprim dhe fjalë tonën. Ndjehej jo pak madje, edhe mungesa e mjedisit intim në pjesën e shtëpisë ku rrinte gjinia femërore, qëndrimi në të cilën shoqërohej me biseda të pandërprera, me vrojtimin e “të huajave”, me prekje të shpenguara, me përqafime, puthje, shtrëngime të pjesëve të zbuluara të trupit, përfshirë dhe kapje në faqe.

Afërsia e lejuar ndaj të anketuarve që i përkisnin një kulture tjetër, përcaktohej sipas rastit. Çdo herë duhej peshuar mirë se ku, kur, me kë dhe sa duhej shfaqur dhe theksuar fakti që ti je i huaj dhe nuk i përket grupit të njerëzve që po studion. Shoqëria e traditës, brenda së cilës ne jetuam ato ditë, kishte një hierarki tejet të rreptë, ndërkohë që kodi i sjelljes ishte i formalizuar. Për ne u bë e domosdoshme të fitonim vendin tonë në këtë hierarki, si individë dhe si pjesëtarë të këtij kolektivi, duke e baraspeshuar atë me lirinë e pjesëtarëve të tjerë

⁶ Këtu nuk e kemi fjalën për vështirësi të kuptueshme të jetës së përditshme, ose për vështirësitë e punës në festat si dasma, kur muzika gjëmon me zë të lartë, kur të gjithë janë të entuziazmuar e të zënë me pjesëmarrjen në rite. Po theksojmë megjithatë një fakt të rëndësishëm. Plani paraparak i studimeve i D. S. Ermolinit (ritet e varrimit dhe kultura e varrimit) në vitin 2009 u korrektova për shkak të ceremonive të dasmës në familjen që na kishte mikpritur. T’i pyesje të anketuarit mbi çështje të tematikës së paraparë, ndërkohë që ishin zënë me telashet e dasmës, nuk do të ishte etike.

të grupit tonë në veprimet e përditshme, pa shpërdoruar respektin e thellë ndaj shoqërisë që na kishte mikpritur, dhe as mirësjelljen në grup. Kështu, sido që po jetonim “në shtëpinë e të tjerëve, por sipas rregullave tona”, na u desh të ngulmonim për të ngrënë ushqim me të gjithë pjesëtarët e ekspeditës së bashku dhe jo burrat veç e gratë veç në kohë të ndryshme, megjithëse kjo ishte shkelje etike për burrat vendas që kishin ndarë sofrën me ne.

Puna në mjediset me kulturë të huaj mbart edhe problemet e sjelljes, pasi pjesëtarëve të ekspeditës u duhet të përfshihen “si duke luajtur” në ritualet dhe në jetën ekonomike e familjare të të anketuarve, dhe për pasojë e kanë të vështirë të përcaktojnë se ku mbaron loja dhe ku fillon vetë jeta (kjo vihet re në rastin e marrëdhënieve që lindin gjatë kohës së përmbushjes të riteve të dasmës si, për shembull, lidhja e kumbarisë dhe vallet; në mënyrën e të sjellurit ndaj anëtarëve të ekspeditës, e cila, të paktën nga jashtë, nuk ndryshon nga mënyra e të sjellurit me të afërmit; në marrëdhëniet ndërmjet gjinive). Çdo herë, aty për aty, lindte nevoja për të vendosur nëse duhej marrë pjesë apo jo në një ritual ose vallëzim dhe kjo në kushtet e lutjeve këmbëngulëse. Në shoqëritë tradicionale, vendi i zënë në hierarkinë e përmbushësve të ritualit mund të shkaktojë detyrimet kundrejt pjesëtarëve të tjerë në jetën reale, të cilat një studiues, e në veçanti ai pa përvojë, mund edhe të mos i dijë.

Si përfundim, një ekspeditë trevjeçare dhe një studim gjithëpërfshirës pesëvjeçar mbi dukuritë e pikëtakimit të gjuhës dhe të kulturës, që lidhen me linguistikën, etnolinguistikën dhe etnografinë e një rajoni të ndërlikuar shumëtnik, na lejuan të njohim disa veçori të identitetit të popullsisë vendase, të kulturës së sigurimit të jetesës dhe tërësisë së punëve të përditshme, të gjuhës, folklorit, traditave dhe besimeve. Rezultatet paraprake të punës së bërë i janë paraqitur, gjatë viteve të fundit, opinionit shkencor në konferenca të ndryshme, në veçanti në Konferencat filologjike ndërkombëtare të përvitshme të UShSt-P-së dhe në “Втора международна конференция. Актуални проблеми на балканистиката и славистиката. Великогърновски университет Св. св. Кирил и Методий. 9—11.11.2012. Велико Гърново, 2012”.

Pjesëmarrësit e ekspeditës janë autorë të kapitujve të monografisë sonë kolektive në përputhje me interesat e tyre shkencore. Për shkrimin e kapitujve plotësues të librit, me materialet e mbledhura prej nesh, në Sankt-Peterburg u ftuan specialistët e gjuhësisë shqipe, fitonimisë ballkanike dhe sllave A. Ju. Rusakov, M. V. Domosileckaja dhe V. B. Kolosova, të cilët nuk kishin qenë pjesë e drejtpërdrejtë e ekspeditës në terren, por që me punimet e tyre profesionale plotësuan më së miri mozaikun e përgjithshëm.

Nëntitulli i librit “Nga materialet...” do të thotë, që autorët nuk pretendojnë se përshkrimi dhe analiza në të është shteruese, përfshirë faktin që në libër nuk janë mbledhur të gjitha materialet që autorët kanë në dispozicion, një pjesë të të cilave shpresojnë t’i botojnë në të ardhmen. Materialet gjuhësore sllave nga Golloborda publikohen në transkriptimin e Atlasit linguistik mbarësllav, por në kapitujt “Sistemi i termave të farefnisës dhe etiketa familjare”, “Rituali i lindjes”, “Rituali mortor-përkujtimor dhe kultura e varrimit”, janë të dubluara, gjithashtu, me alfabetin cirilik maqedonas e ndonjëherë serb; ndërsa të dhënat gjuhësore shqipe jostandarde janë paraqitur në formën e pranuar tradicionalisht në dialektologjinë shqiptare.

Gjatë punës në ekspedita ne e kemi përmbushur rreptësisht rregullin që të mos bëjmë pyetje të drejtpërdrejta lidhur me marrëdhëniet fetare, vetëdijen dhe gjuhën, të mos përmendim linqonime ose etnonime (emërtime gjuhësh ose etnosesh), me përjashtim të *gjuhë ruse* dhe *rus*. Autorët i njohin mjaft mirë pikëpamjet që kanë shkencëtarët shqiptarë, maqedonas dhe bullgarë për çështjet që lidhen me vetëdijen dhe identitetin e banorëve sllavishtfolës të Gollobordës. Duke falënderuar sinqerisht kolegët ballkanas për përsëritjet e shpeshta të pikëpamjeve të tyre në publikime, konferenca dhe biseda, në këtë monografi ne kemi parapëlqyer të mos dalim jashtë suazës së diskursit objektiv shkencor.

BALLKANI PERËNDIMOR: MIKRORAJONET KUFITARE⁷ DIBËR DHE GOLLOBORDË

Andrea N. Sobolev

Regjionet e Ballkanit dhe regjionologjia ballkanike. Në pjesën malore të tij gadishulli i Ballkanit ka mjaft rajone të vogla, të izoluar dhe të përshtatshme për jetesë (lugina e gropa), popullsia e të cilave nuk është shumë e madhe dhe mbetet relativisht e veçuar, duke përbërë zakonisht — por jo gjithmonë — njësi unike në planin politiko-administrativ, etnografik, gjuhësor, kulturor dhe ndonjëherë edhe ekonomik. Me organizimin mbi bazë “bashkësie” të sociumit (si të trashëguar ashtu dhe të rilindur pas pushtimit osman) një rajon i tillë është shpesh vend i jetesës së fisit ose grupit të fiseve, d.m.th. të një grupi njerëzish, të cilët e konsiderojnë veten fis sipas linjës atërore, qoftë edhe në mënyrë fiktive (serb. *племе / plleme, бра(м)ство / bra(t)stvo*, shq. *fis, -i; vllazni, -a*). Në periudhën bizantine këto rajone greqisht quheshin *χωρά* ‘vend, tokë’, në Mesjetë në shtetet sllave të jugut — *жупа / zhupa*, d.m.th. përbënin një njësi territoriale administrative me një qendër të fortifikuar (leksemë sllave me prejardhje indoeuropiane, e afërt me gjerm. *Gau* ‘rreth’ [Георгиев и др. 1971: 559; Skok I 1971: 687; Благојевић 2006]). Në Shqipërinë e sotme këto quhen *krahina*, që mund të jenë qytete së bashku me rrethinat (*krahina e Beratit, e Korçës*), një rajon i izoluar malor (*krahina e Lurës, e Skraparit*), ndonjëherë territori i banuar nga farefisi (*krahina e Kelmendit, e Krasniqit*), ose territore të mëdha (*krahina e Dibrës*). Dihet mirë se Gegëria e Shqipërisë (geg. *Gegnia*) historikisht ka qenë gjithashtu një mikrozonë e tillë, emërtimi i së cilës u shtri praktikisht në të gjithë Shqipërinë Veriore, ndërsa ai i Toskërisë (tosk. *Toskëria*) u shtri në gjithë Shqipërinë Jugore (shih rikonstrukcionin e kuptimeve fillestare në shikimin klasik të dialekteve shqipe të bërë nga etnologu shqiptar Rrok Zojzi [Десницкая 1968:

⁷ Ky kapitull është pjesë e monografisë që u botua në vitin 2013 [Соболев 2013].

53, 47]). E prapëseprapë sot këto përgjithësime fshehin një tablo të hollësishtme të ndarjes rajonale të vendit në zonat e Myzeqesë, Labërisë, Çamërisë etj.⁸

Zonat etnografike të gadishullit, si rregull, në të gjitha periudhat e historisë, kanë qenë polietnike, dhe në to zakonisht ruhen gojëdhëna mbi popullsinë e hershme (*Mavriq* në rajonin e Dukagjinit të sotëm, fiset Shala dhe Shosh; *Macure* në rajonin e fisit Piperi në Mal të Zi, po ashtu në Mal të Zi *Mataruge*, *Kriçi*, *Španji*, që të çojnë në substratin romak në rajon). Në këto zona mund të formohen grupe subetnike.

Në cilësinë e termit unik të përcaktimit të njësisë minimale territoriale antropologjike mund të shfrytëzohen derivatet prapashtësore të sll. **krajь* ‘fund, segment’, të cilat shërbejnë në gjuhët e sllavëve të jugut dhe të shqiptarëve për përcaktimin e rajoneve të veçanta — serb. dhe kr. *krajina*, shq. *krahinë* dhe bullg. *краице* / *kraishte*.⁹ Në rusisht kjo fjalë do të tingëllonte *краина* / *kraïna*. Kështu pra ky është një rajon jo i madh, që paraqet unitet në drejtimin gjeografik, ekonomik dhe etnografik (tipi i banesës, ritet që lidhen me kalendarin, ushqimi tradicional etj.) dhe që ndonjëherë del në histori si një i tërë, d.m.th. si njësi e veçantë territoriale. Njësi të minimale antropogjeografike në Ballkan shpesh, megjithëse jo gjithmonë, u korrespondojnë njësitë

⁸ Shkenca europianoperëndimore praktikon, kryesisht, hulumtimin e rajoneve të “mëdha” të Ballkanit (shih projektet e Akademisë Austriake të Shkencave në Vjenë — *Tabula Imperii byzantini*, *Atlas Ost- und Südosteuropa*, *Das Südosteuropa der Regionen* ose përmbledhjen më të re ndërkombëtare mbi Shqipërinë e Veriut [Genesin, Matzinger 2009]), e cila është përfaqësuar mirë edhe në etnografinë bullgare (shih serinë “Етнографски проучвания на България” — Dobrukha, krahina e Pirinit, Bullgaria Verilindore, Rodopet, krahina e Plovdivit, krahina e Sofjes, Stranxha, krahina e Loveçit).

⁹ Në gjuhën bullgare është fiksuar përcaktimi i rajoneve të tilla me anë të mbiemrave relativë të substantivuar të gjinisë asnjënjëse të tipit *Дебърско* / *Debërsko*, *Костурско* / *Kostursko*, *Солунско* / *Solunsko*, *Русенско* / *Rusensko*, *Провадишско* / *Provađijsko*, *Разградско* / *Razgradsko*, *Карнобатско* / *Karnobatsko*, shpesh të formuar nga emërtimi i qendrës së banuar më të rëndësishme.

linguistike, zakonisht në nivelin e së folmes të ndonjërit prej dialekteve të mëdha të gjuhës etnike. Disa krahina, popullsia e tyre në tërësi dhe disa përfaqësues të saj në veçanti, kanë luajtur rol të jashtëzakonshëm në historinë dhe në kulturën e gadishullit dhe, në të njëjtën kohë, si në miniaturë i paraqesin vëzhguesit ecurinë dhe rezultatet e larmishme të ndërveprimit gjuhësor, kulturor dhe etnik ballkanik (khs. p.sh. *Dibër / Дебар / Дубра* në shekujt e Mesjetës [Schmitt 2009]). Krahinat Malësia, Metohia dhe Dibra edhe sot e kësaj dite mbeten zona kontakti (ka mundësi dhe simbioze) të popullsisë sllave dhe shqiptare, që meritojnë vëmendje më të përqendruar.

Botimi i monografive komplekse, shpeshherë mjaft të hollësishme, arkeologjike, historike, etnografike e linguistike të krahinave të ndryshme përbën një traditë të gjatë e të suksesshme të vendeve të Ballkanit. Thëksojmë në veçanti punimet klasike që janë botuar në serinë beogradase “Српски етнографски зборник”, ndërsa nga botimet prestigjioze shqiptare të kohëve të fundit përmendim, për shembull, veprën kolektive tepër informative dhe të hollësishme mbi Himarën [Nasi 2006].

Rajoni Dibër / Дебар / Дебър. Treva, e cila në hartën e Ptolemeut quhet *Deborus* (krahaso emërtimin e qytetit peonian në rrjedhjen e sipërme të Strumicës *Doberos*), nga sllavët e jugut quhet *Дебар / Дебър* (prasllav. **dъbrъ / дъbrъ*, khs. rus. *дебру*; ilir. **dobēr-* ‘Schlucht’ [Mayer 1959: 41]), ndërsa nga shqiptarët *Dibër*,¹⁰ një territor ky mjaft i izoluar nga bota e jashtme, shtrihet në veriperëndim të rajonit gjeografik të Maqedonisë, në të dyja anët e kufirit të sotëm politik ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Shqipërisë. Lumi Drini i Zi (maq. *Црни Друм*, shq. *Drini i Zi*, lat. *Drinius*, greq. *Δρεῖνος* < ilir. **Drūn* ose **Drī-* prej i.-e. **drū-* ose **der-eu* ‘rrjedh’; khs. gjithashtu

¹⁰ Në Ballkan ka mjaft vende me këtë emërtim, p.sh. në Epir — *Dibra* (*Διβρα*) > sot *Dhivri* [Soustal 1981: 142]. Përputhja e rastësishme në tingëllim me fjalën turke *dübür* “pjesa e pasme e diçkaje” jep mundësi për shpjegimin me etimologji popullore të toponimit duke marrë si bazë turqishten [Гирфанова 2004: 98].

Δρίλων [Mayer 1959: 42—43; Георгиев и др. 1971: 427—428], i cili ushqehet nga burimet nëntokësore në liqenin e Ohrit, e ndan atë në pjesën e sipërme dhe të poshtme. Në shekujt e Mesjetës në këtë rajon ka pasur vetëm dy qytete në kuptimin e vërtetë të fjalës: Rahovniku (sot ka të ngjarë të jetë Dibra / Дебар në Republikën e Maqedonisë) dhe Peshkopia (sot Peshkopia në Republikën e Shqipërisë, emërtim nga greq. *ἐπισκοπή*, lat. *episcopium* ‘rezidenca e peshkopit’); por ka pasur edhe pika të fortifikuara, p.sh. *Svetigradi*. Në kohën e Bizantit dhe të Perandorisë Osmane kufijtë e rajonit si njësi territoriale-administrative kanë qenë të lëvizshëm. Peshkopia, siç mund të merret me mend, ka qenë rezidenca e peshkopit dhe vendndodhja e manastirit ortodoks, ajo ka qenë gjithashtu dhe qendër tregtare e luginës, e cila, pas pushtimit osman në mesin e shekullit XV, nuk ka pasur më shumë se 200 banorë.

Popullsia (deri në 40 mijë vetë) ishte fshatare dhe është marrë me bujqësi dhe blegtori, duke qenë heterogjene nga përbërja etnike dhe linguistike: në shekujt e Mesjetës këtu kanë banuar sllavë, shqiptarë dhe vllah romanofolës (sipas dëshmisë së biografit të Skënderbeut, Barletit, në shekujt e Mesjetës gjithë popullsia e Dibrës, që përbëhej nga “shqiptarë”, “epirotë”¹¹ dhe “bullgarë” ka qenë ortodokse); në kohën e sotme banojnë shqiptarë katolikë (në fshatin Muhurr *Kisha e malit të Shën Mërisë*, në qytetin e Bulqizës *Kisha e Dushajt* dhe *Kisha e Kaziakut*) dhe shqiptarë ortodoksë (*укрети / shkreti* [Мирчевска 2007]), maqedonas ortodoksë (maq. *мијак / mijak, мијаџи / mijaci*), sllavë myslimanë (ekzonim maq. *торбешу / torbeshi* [Паликрушева 1991], romë dhe turq.

Pikërisht këtu folklori demonstroi kombinime elementesh të gjuhëve të ndryshme si në tekstin e njohur shqiptaro-turko-maqedonas nga fshati Tanushë [Недельковић 1934: 41; Koneski et al. 1970: 80]:¹²

¹¹ Në shkencën shqiptare është shprehur mendimi të paktën si minimum mbi sinoniminë e pjesësme të leksemave Epirot dhe Arbër (d.m.th. ‘shqiptar’) shih [Dulaj 1989].

¹² Krahaso gjithashtu nga Malesheva: *Оздол иде врашка мома, турски поје, грчки дума, арбанашки одговара* [Јашар-Настева 1987: 17].

Kuplet

Имаш очи

Како филџан.

Refren

Јанддим, аман;

Јалвараим.

Гел јанума.

Пат бој риџа, чиџо,

Фале и чеи му.

Сојле, бенимле оф, оф!

Збори сос мене!

“Ke sytë

[të mëdhenj] si filxhan.

Unë vuaj, o aman;

të lutem.

Hajde tek unë

“Axha të pret në rrugë, o çikë”,

Fol e qesh me mua.

[Më këndo], folmë mua, oh, oh!

Fol me mua!”

Karakter i dialektor i pjesës turqisht bie menjëherë në sy¹³: rregullat e harmonisë të zanoreve nuk janë respektuar, ka bashkëtingëllore të dubluara, ngatërrohen kohët dhe mënyrat e foljes etj. Pjesa maqedonisht dhe shqip, nëse gjykon nga parametrat fonetikë (maq. *nam* / *pat* ‘rrugë’ dhe shq. dial. *boj* ‘bëj’) mund të tregojnë plotësisht dialektet e gjuhëve përkatëse në Dibër.

Që në fund të shekullit XIX dhe fillim të shekullit XX për të folmen e fshatit Klenjë ka shkruar Vatroslav Oblak [Oblak 1896], kanë dalë shkrime të shumta mbi Galiçnikun [Григоров 1907], madje në vitin 1899 edhe në Rusi, Pavell Apollonoviç Rovinskij ka botuar në revistën «Живая старина» (rus. ‘Zakonet e gjalla’) (Nr. I dhe II, f. 113—129, 236—250) materiale origjinale të galiçnikasit Panajot Gjinovski; krahaso gjithashtu [Икономов 1893; Недельковић 1934]. Pavarësisht nga disa botime të reja mbi të folmen maqedonase të rajonit, përfshi këtu dhe një pasqyrë të literaturës paraardhëse [Конески 1977; Видоески 1999; Ylli, Steinke 2009], mbi të folmen shqipe të rajonit [Весі 1987; Юллы, Соболев 2003], mbi toponiminë [Стаматоски 1990: 46—51; Коробар-Белчева 1990; 1998], mbi dasmën si rit kalimi nëpër stadet e jetës të “mijakët” dhe “bërsjakët” [Петреска 1998], mbi kumbarinë dhe vëllamërinë [Лиманоски 1986] dhe aspekte të tjera të kulturës popullore dhe

¹³ Sipas njoftimit personal të docentes Krasimira Koleva, Universiteti i Shumenit.

historisë së “mijakëve” [Огњановиќ-Лоноски 2004; Поповски 2006], mbi historinë, fenë dhe kulturën e sllavëve myslimanë [Паликрушева 1965; Лиманоски 1989; 1993], në literaturën shkencore ballkanike jo vetëm që mungon një veper përmbledhëse sintetike mbi ndërveprimin gjuhësor dhe kulturor në Dibrë, por mungojnë dhe studime të vogla për secilin nga grupet që popullojnë rajonin (monografitë dhe përmbledhjet shqipe zakonisht, për fat të keq, nuk dalin jashtë kufijve të studimeve amatore, shih [Daci 2006; Kadiu 2010]).

Burimet tona kryesore për demografinë e Ballkanit, të shekujve të Mesjetës në tërësi dhe Dibrës në veçanti, janë regjistrat kadastralë dhe tatimorë turq (*tahrir defterleri*), të mbajtur që në shekullin XV dhe që përfshijnë përshkrimin e të gjitha ekonomive të sanxhakut (dhe nahijeve të tij me çdo fshat) si pasuri e tundshme dhe e patundshme e çdo taksapaguesi dhe detyrimet e tij tatimore, me të dhëna për zotërimin dhe përdorimin e tokës, prodhimin, të ardhurat e pritshme, për fenë e popullsisë (për arsye të taksave për frymë), statusin juridik të ekonomive të veçanta (ngastrat e vasalëve, manastiret etj.). Analiza e defterëve turq të shekullit XV të Dibrës [Pulaha 1968; Соколки 1973; Стојановски 1978] tregojnë se në shumë fshatra fqinje banonin njerëz me emra shqiptarë dhe sllavë: *Pop Gjergj, Gon Sope; Dapče Petkov, Stepko Petković*. Është domethënëse mungesa e emrave, të cilët ne do të mund t'i karakterizojmë si romanë apo vllahë. Mendohet se maqedonasit-*mijakë* të sotëm (të fshatrave Галичник / Galicnik, Лазарополе / Lazaropole etj.) janë romanë të sllavizuar.¹⁴

Pa nxjerrë përfundime për përkatësinë etnike të njeriut duke u bazuar tek emri i tij, ne zakonisht flasim për “mbajtësit” e emrave shqiptarë ose sllavë. Në Dibrën e Sipërme dhe në luginën përreth Peshkopisë kanë banuar kryesisht mbajtës të emrave sllavë me ndërfutje të mbajtësve të emrave shqiptarë, ndërkohë që në fshatrat malore të Dibrës së Poshtme kanë mbizotëruar emrat shqiptarë. Mes mbajtësve të emrave sllavë të Dibrës mesjetare në mënyrë hipotetike mund të veçohen dy grupe: ai serb i përqendruar në Peshkopi dhe i lidhur me kishën dhe shtetësinë

¹⁴ *Miac, -că, Miați, -țe* ‘membre d’une ancienne population aroumaine — aujourd’hui complètement slavisée’ [Papahagi 1974: 796].

mesjetare serbe, që depërtonte këtu nga Kosova nëpërmjet luginës së Drinit të Zi (emrat *Miloš Životar, Bojo Stanišić, Đuro Solović*), dhe ai bullgar i lidhur historikisht me shtetësinë mesjetare bullgare me qendër në liqenet e Prespës, si dhe me ndikimin kulturor të Peshkopatës së Ohrit (emrat *Dimitri Petkov, Neno Stanislav, Dapče Bogosllav, Petko Košničani*).

Në kohën e re mjeshtrit e gdhendjes së drurit i kanë dhënë famë rajonit të tyre me tavanet e shtëpive qytetare (p.sh. në Peshkopi) dhe me ikonostaset e kishave (maq. *Јован (Претеча) Бигорски*, shq. *Manastiri i Shën Bigorit*) të gdhendura në mënyrë artistike.

Mund të themi se në Mbretërinë Bullgare me qendër në liqenet e Prespës, e cila përfshinte edhe Dibrën, të gjithë banorët morën fenë ortodokse, për çka dëshmon edhe fakti se në një sërë fshatrash që ndodhen sot në Dibrën maqedonase (maq. *Горна Река / Gorna Reka*, shq. *Reka e Epërme* etj.) jetojnë shqiptarë ortodoksë, që quhen *укрети / shkreti*. Me çështjen e kufijve të shtrirjes së ortodoksisë në Ballkanin Perëndimor është marrë shumë Millan Shufflai (Milan von Šufflay) [Šufflay 1916] qysh në fillimin e shekullit XX. Ndërsa Oliver Shmitt (Oliver Schmitt) në biografinë më të fundit shkencore të Skënderbeut [Schmitt 2009] pohon se në Mesjetë, madje, ortodoksia ka qenë bërthamë e identitetit të banorëve të Dibrës. Sipas mendimit të tij, ndërmjet grupeve gjuhësore nuk kishte tension, përderisa liturgjia ishte e njëjtë, organizimi i shoqërisë ishte i ngjashëm, ndërsa mënyrat e zhvillimit të ekonomisë nuk ndryshonin: në luginë kultivoheshin drithërat, zhvillohej kopshtaria dhe bletaria, në male — blegtoaria. Por shqiptarët, sipas dëshmive të bashkëkohësve, gjithsesi i konsideronin sllavët besëtytë.¹⁵ Në planin kulturor banorët prireshin nga Ohri,

¹⁵ Për prirjen e veçantë ndaj besëtytnive mund të gjykohej, për shembull, nga shtirja fall e vajzave sllave për bashkëshortin e ardhshëm dhe martesën. Në veçanti, te bullgarët kjo bëhet edhe natën para ditës së Shën Vasilit (Viti i Ri), edhe në të Dielën e Dafinave (e Diela e Lazarit ose e Palmave ndër katolikët), edhe në ditën e Todrit dhe të Shën Gjon Pagëzorit (24.VI/7.VII). Në vigjilje të ditës së Shën Vasilit në fshatin Горно Павликени / Gorno Pavlikeni vajzat

kryeqyteti kishtar me ndikim, i cili shtrihej në luginën pjellore pranë liqenit, që ishte vendndodhja e Peshkopatës më të famshme në të gjithë Ballkanin. Ky ishte një qytet i pasur me kisha dhe me shtëpi banimi, të cilat mahnitnin përfytyrimin e banorit të thjeshtë, që në shekullin XV jepte 15 mijë dukatë në vit të ardhura. Dhe pikërisht nga kjo botë e ka prejardhjen familja e Kastriotëve, e cila ka luajtur një rol jashtëzakonisht të rëndësishëm në historinë e Ballkanit dhe të Shqipërisë.

Vëzhgimi me një optikë maksimale na lejon të dallojmë përbërësit e shumtë të rajonit të Dibrës, si dhe ndarjen e tij në zona të vogla si Reka e Vogël (Мала Река / Mala Reka), Reka e Madhe (Голема Река / Golema Reka), Pole (Поље / Polje ‘Fushë’), Zhupa (Жупа / Župa), Drimkollli (Дримкол / Drimkol), Grika (Грика / Grika), Golloborda e Sipërme (Долно Голо Бордо / Dolno Golo Bordo), Golloborda e Poshtme (Горно Голо Бордо / Gorno Golo Bordo), ose Pllanina (Планина / Planina). Është fare e qartë se përcaktimi i përfundimeve të mëdha është i pamundur pa kryerjen e studimeve të vogla analitike (angl. case study, gjerm. Fallstudie). Burimi më i besueshëm i informacionit, që lejon të studiohen gjuhët dhe kulturat ballkanike me një qasje dhe saktësi sa më të madhe ndaj së vërtetës, është vëzhgimi i drejtpërdrejtë i banorëve të civilizimit ballkanik nga afër për së brendshmi, ndërkohë që studiuesi i jashtëm, sado që të përpiqet të fshijë kufirin mes botës së tij dhe botës që studion, gjithsesi mbetet i jashtëm. Shkrimet, që kanë ardhur deri te ne si burime të dorës së dytë, siç janë tekstet e Kostantindinit VII Porfirogenetit, të dhënat nga aktet e dhurimit manastireve serbe, regjistrimet bizantine të fshatrave

hidhnin unaza në një kazan me ujë të pastër, ndërsa në mëngjes kërcenin valle rreth tij, nxirrnin një nga një unazat dhe këndonin. E ardhmja e të zonjës së unazës përcaktohej në përputhje me fjalët e këngës që këndohej në atë moment (*Овците идат, в село влизат, дай Ладо ле, брѣкни, булне, извади прѣстен, дай Ладо ле!* (bari); *Сребърна чашиа през Дунав плава...* (i huaj); *Босо зайче на прѣтинка...* (i varfër); *Шарени торбе гости чакат...* (do të martohet sivjet); *Шута риза, недоишта...* (nuk do të martohet sivjet) [Романска 1965: 35—36]. Përkundrazi, autorët sllavë të krishterë, p.sh. meshtari bullgar Kozma në librin “Biseda kundër bogomilëve” (shek. X), i dënonin “ata që besonin te fati dhe ëndrrat”.

dhe ekonomive, të dhënat e defterëve osmanë,¹⁶ vrojtimet vetjake të udhëtarëve, si të Evlia Çelebiut, të U. M. Likut, A. F. Gilferdingut apo raportimet e diplomatëve nga Perandoria Osmane (shih [Селишев 1931]), nuk mund të krahasohen as me autorefleksionin e raçmuar nga brenda mikrobotës ballkanike, që na kanë lënë njerëzit e arsimuar vendas (në autobiografitë e shumta ballkanike, për shembull e Sofronij Vračanskit, dhe në veprat artistike të autorëve ballkanikë), as me vëzhgimin afatgjatë të organizuar të etnografëve, antropologëve dhe gjuhëtarëve të përgatitur profesionalisht, përfshirë dhe diplomatë me shumë kulturë si Ivan Stepanoviç Jastrebov [Ястребов 1904]. Për popullsinë sllave të rajonit të Dibrës, numri i dëshmimeve të burimit të parë është jashtëzakonisht i vogël, çka vetëm se e rrit vlerën e tyre shkencore; siç janë p.sh. “Udhëzimi” autobiografik i Gjurçin Kokallit nga fshati Llazaropole (1775—1824) (botuar me komente në [Белић 1935]) dhe përshkrimi anonim i zonës së Dibrës të viteve 80 të shekullit XIX nga fshati Galiçnik (botuar me komente në [Конески 1977]). Kundërvëniet kryesore të grupeve të popullsisë në përshkrimin e fundit janë konfesionale: *рисјани / risjani ~ турци / turci ~ латини / llatini*, gjuhësore *арнаутски / arnautski (шкиптарски / shkiptarski) ~ славјански / sllavjanski (рисјански / risjanski, мијачки / mijački) ~ турски / turski*, lokale: *мијаџи / mijaci ~ брејаџи / brsjaci ~ курки / kurki ~ улуфу / ullufi*.

Rajoni i Gollobordës (Голо Бордо / Golo Bordo). Forma e brendshme e këtij toponimi, pa dyshim sllav (**golo bърdo*)¹⁷ është ose ‘mal i zhveshur’, çka bie në kundërshtim me faktin se rajoni është i

¹⁶ Krahaso elementet onomastike *Ѓин Лазаревиќ / Gjin Lazareviq, Ѓон Својмир / Gjon Svojmir, Ѓон Влашиќ / Gjon Vllashiq* me përbërës shqip, romanë dhe sllavë. Për shekullin XXI, mbetet gjithsesi thelbësor fakti që pema gjenealogjike e familjes Cfarku, në kundërshtim me mendimin e studiuesve [Ylli, Steinke 2008: 26, shënimi 26], nuk përmban emra osmanë apo myslimanë (emri *Guzman* për ne është i njohur jo si mysliman, por si emër i kalendarit të krishterë, zakonisht në formën *Кузман / Kuzman*).

¹⁷ Në pjesën perëndimore të Ballkanit ky toponim ndeshet, tashmë sipas defterëve osmane, dhe në rajonin e liqenit të Shkodrës [Пешиќан 1983: 39].

pasur me pyje dhe bimësi tjetër, ose ‘vetëm mal dhe asgjë tjetër’, d.m.th pa ndërfitjen e rrafshinave,¹⁸ ka të ngjarë të jetë dhe shtrembërim i një emërtimi edhe më të vjetër **dьlgo bьrdo* ‘mal i gjatë’, i përcaktuar si *Vilayet — I Dolgo Brdo* në defterin osman të vitit 1467. Lidhja e këtij emërtimi me emërtimin italian të Kalabrisë (provinca Calabria) dhe me shqiptarët-arbëreshë që e popullojnë atë (shih më hollësisht në [Sadikaj 1999]) është pseudoshkencore.

Kufijtë e territorit dhe ndarja e tij në Gollobordën e Poshtme (Долно Голо Бордо / Dolno Golo Bordo), ose Рамна Гора / Ramna Gora, dhe të Sipërme (Горно Голо Бордо / Gorno Golo Bordo), ose Pllanina (Планина / Planina) me cilësimin e banorëve si *пољани / pol'ani* (fushorë) dhe *планинци / planinci* (*шопој / šopoj*) (malësorë) i gjejmë tek [Филиповић 1940: 9—10]. Përshkrimi i mikrorajonit të Gollobordës në literaturën shkencore fillon me të dhënat mbi vendndodhjen e tij në hartën fiziko-gjeografike të gadishullit të Ballkanit dhe me kufijtë me mikrorajonet fqinje shqiptare dhe maqedonase (përkatësisht Çermenikën, Martaneshin, Grykën e Madhe, Grykën e Vogël, Zhupën e Dibrës dhe Drimkollin e Dibrës), me të dhënat historike dhe onomastike të defterit osman të vitit 1467 [Паликрушева, Стојановски 1969], me informacionin mbi problemin e ndarjes politiko-shtetërore ndërmjet Shqipërisë dhe fqinjëve të saj sllavojugorë (një pjesë e fshatrave, që tradicionalisht hynte në Gollobordë i kanë kaluar shtetit fqinj sllavojugor, për shembull Xhepiшти (Цепишта / Džepišta) dhe Drenoku (Дренок / Drenok)). Zakonisht studimi i mikrorajoneve të tilla në Ballkan realizohet në nivelin e fshatrave dhe lagjeve të tyre, si dhe të grupeve etnografike të fshatrave; konstatohet, për shembull, se aktualisht në këtë rajon nuk ka mbartës të gjuhës arumune, kurse mbartësit e dialektit lokal sllav (kryesisht myslimanë-sunitë të devotshëm me ekzonimin *торбеши / torbeši* dhe rrallë të krishterë-ortodoksë) banojnë vetëm në fshatrat që mbajnë emërtimet zyrtare shqip Gjinovec, *Klenjë,¹⁹ Kojavec, Lejçan, Lladomericë, Orzhanovë, Ostren i Madh, Ostren i Vogël, *Pasinkë,

¹⁸ Krahaso me rus. *голая правда* ‘e vërteta lakuriq’.

¹⁹ Me shenjen * janë shënuar emërtimet e fshatrave, ku ka popullsi ortodokse.

Radovesh, *Steblevë, Trebisht, Tuçep, *Vërnice dhe Sebisht. Popullsia shqipfolëse në rajon është kryesisht myslimane-sunnite, por rrallëherë ndeshen dhe katolikë. Në vitet 1930 janë hasur këto etnografonime: *Курку / Kurki* — emërtim pejorativ për gollobordasit nga ana e banorëve të fshatrave në bregun lindor të Drinit; *Шонје / Šopje* — emërtim pejorativ për gollobordasit, por edhe për banorët e tjerë të Dibrës; *Објало / Objalo* — emërtim pejorativ nga ana e gollobordasve për rekanasit, banorët përtej anës tjetër të lumit; *Латину / Latini* — emërtim i banorëve të fshatrave shqiptare Zabzun (Забзун) dhe Zerqan (Здрчани / Zdrčani) nga ana e sllavëve. Popullsia e rajonit në përgjithësi merrej me bujqësi dhe blegtori, por burrat punonin masivisht në të gjithë Ballkanin (në shekullin XX kryesisht në Shqipëri dhe Greqi) si ndërtues-muratorë dhe marangozë (duke zotëruar mjeshhtërinë e ndërtimit të shtëpive të banimit, urave, rrugëve, kullave, xhamive, minareve, fabrikave dhe furrave); pikërisht brigadat e ustallarëve nga ky rajon përhapën në të gjithë gadishullin tipin e shtëpisë dibrane të njohur gjerësisht (shih muzetë etnografikë në Pirot, Shkodër, Berat, Kostur etj.). Në bazë të dialekteve vendore, me ndërkallje fjalësh nga gjuhë të huaja, janë formuar argo të fshehta të ndërtuesve të Ballkanit (për argotë sllave dhe shqipe shih [Efing, Leschber 2009]).

Brenda kufijve të mikrorajonit veçohet një zonë e vogël, tepër e vështirë për ta shkëlur, *Горно Голо Бордо / Gorno Golo Bordo*, ose *Планина / Planina* (etnografonimi *Планинци / Planinci*), ku dhe u zhvillua ekspedita. Banorët e kësaj zone përpara mbylljes së kufijve shkronin për të bërë pazar në Dibër dhe në Strugë, ndërsa në Shqipëri ky rol i kaloi Peshkopisë. Në këto fshatra edhe në shekullin XX nuk ka pasur qere e slita, gjithë ngarkesat zakonisht transportohen me kuaj, me gomarë dhe shpinën e grave (khs. *везник / veznik* ‘deng’). Këtu ka qenë një famulli e Kishës ortodokse shqiptare, më parë me qendër në fshatin Gjinovec (Ѓиновец / Gjinovec, variant i emërtimit Гине(в)ец / Gine(v)ec).

Nga historia e studimit të gjuhës dhe kulturës së Gollobordës. Vrojtimi i drejtpërdrejtë i jetës, kulturës dhe gjuhëve të rajonit, u bë i mundur për specialistët e kualifikuar, fatkeqësisht, vetëm në fund të shekullit XIX. Njëri nga këta specialistë ishte Milenko Filipoviçi (Миленко Филиповић), i cili në vitin 1940 ka publikuar të dhëna unikale

mbi mikrorajonin sllavo-shqiptar të Gollobordës (duke përmendur dhe emërtimin e vjetër Дулгоберда / Dulgoberda, si dhe emërtimin Дримкол / Drimkol, tepër i rrallë dhe jo krejt i saktë në lidhje me Gollobordën).²⁰ Në shekullin XX dhe XXI për rajonin shfaqin interes edhe autorë serbë, edhe bullgarë, edhe maqedonas, edhe shqiptarë [Асенова 1997; Бояджијев 2007; Христова 2007; Лиманоски 1992; Дрвошанов 1995; Видоески 1998; Светиева 2006; Sadikaj 1999], por studimi më i thellë i komponentit sllav është bërë nga Xhelal Ylli në vëllimin përkatës të serisë së Munihut “Pakicat sllave në Shqipëri” [Ylli, Steinke 2008: 9—247]. Gjuhëtari shqiptar ka sjellë një material të besueshëm dhe më aktualin mbi vendet e sakta të banimit të popullsisë sllave dhe shqiptare sot (në veçanti, është shqyrtuar struktura e popullsisë së Gollobordës dhe dinamika e saj, identiteti etnik dhe feja, arsimit dhe kultura), mbi treguesit kryesorë të fonetikës dhe morfologjisë të së folmes sllave dhe mbi disa aspekte të ndërveprimit shqiptaro-sllav (Ylli për herë të parë ka përshkruar bindshëm raportin e ndërsjellë të grupeve gjuhësore dhe fetare në rajon dhe ka drejtuar vëmendjen te strategjia e përzgjedhjes së gjuhës së komunikimit në familje në raste ekzogamie); në libër janë pasqyruar tekste dialektore nga të pesëmbëdhjetë fshatrat sllave të pjesës shqiptare të Gollobordës.

E megjithatë në ende nuk kemi një monografi dialektologjike klasike mbi të folmen sllave të Gollobordës. Përveç librit të Yllit, informacion më i plotë mbi fonetikën dhe gramatikën në termat linguistikë bashkëkohorë mund të merret edhe nga punimet e Bozhidar Vidoeskit [Видоески 1998]. Ndërsa në sferën e leksikologjisë duhet veçuar një fjalor i vogël diferencial dialektor, i cili përmban disa terma që lidhen me festat kalendarike, mitologjinë, fafëfisninë, të drejtën zakonore dhe blegtorinë [Ристески 2006]. Rajoni dialektor i Gollobordës është

²⁰ Po japim vetëm disa dëshmi nga vepra e tij themelore. Për të drejtën vendase zakonore më parë ishte tipike ideja se *Канон шерипат го расунет / Kanon šerijat go rasipet* ‘Kanuni është më i fuqishëm se sheriatit’. Ekziston zakoni i gjakmarrjes (*падна на корф / padna na korf*). Më parë ishin të përhapura legjendat për gjarprin (dragoin), për djalin me krahë (*дете со крилчиња / dete so krilčin’a*), për luftën e dragoit me laminë. Është e pranishme *лагомијата / lagomijata* ‘mbiemri i fisit’ me —ци / -ci ose —ou / -oi.

përfshirë në atlaset dialektologjike kombëtare të Maqedonisë dhe të Bullgarisë. Dhe prapëseprapë, udhëtimet mjaft të shpeshta pas vitit 1989 të entuziastëve bullgarë e maqedonas në Gollobordë, në kuadrin e projekteve të veçuara "Bullgarët jashtë kufijve të Bullgarisë" dhe "Maqedonasit jashtë Maqedonisë", nuk kanë çuar në botime linguistike përgjithësuëse, edhe pse shkrimi i një punimi të plotë themeltar mbi të folmen e Gollobordës është një detyrë studimore tepër fisnike, në veçanti edhe për arsye se kjo e folme nuk mbulohet nga asnjë prej gjuhëve standarde bashkëkohore sllave.

Një përmbledhje e çmuar e fjalëve të urta, proverbave, urimeve, lutjeve, mallkimeve, betimeve dhe gjëegjëzave është botuar para pak kohe në Tiranë me alfabetin latin të shqipes dhe atë cirilik të maqedonishtes [Mazniku, Cfaruku 2009; Mazniku, Koja 2009]; po përmendim dy margaritarë të koleksionit: *Ako beshe ubava rabotana, qa raboteshe i agana*. "Po të qe puna gjë e mirë, do të punonte dhe agai" (f. 17); *Jadi lebot kaurski, prai divata turska*. "Ha bukën e kaurit, e bëj duanë e turkut" (f. 40). Gjuha në këtë botim, të përgatitur nga studiues amatorë të dalë nga Golloborda, quhet maqedonase, më saktë dialekti drimkoll-gollobordas i gjuhës maqedonase [Mazniku, Cfaruku 2009: 13, 15]: "Vo nashiot kraj, Gollobordo, jozikot samo se zborvet a ne se pishit. Xhagurinjata (decata) na shkollo, eve okollu sto godini, uçet samo albanski jozik... Во нашиот kraj, Голобордо, јозикот само се зборвет а не се пишет. Џагурињата (децата) на школо, еве околу сто години, учет само албански јозик".

E folmja shqipe e Gollobordës nuk është përshkruar në ndonjë monografi, e megjithatë vendi i saj në vijimësinë e të folmeve të gegërishtes qendrore përshkruhet në punimin e Bahri Becit, ku, në veçanti, është studiuar e hartografuar materiali gjuhësor i fshatrave Zerqan dhe Okshtun [Beci 1987]. Veç kësaj fshati Tërbaç²¹ është përfshirë në Atlasin dialektologjik të gjuhës shqipe si pika nr. 95 [Gjinari et al. 2007]. Të

²¹ Në literaturën etnografike serbe të viteve 1930, gjejmë se Tërbaçi është "një fshat i pastër mysliman serb me 176 banorë. Në fshat ka një vend që quhet Vakuf: atje nuk i prekin drurët. Pak më tej ndodhet një varrezë e vjetër e krishterë, në të cilën ka ende gurë varresh" [Филиповић 1940: 38].

dhëna të drejtpërdrejta për gjuhën e popullsisë së asimiluar apo të emigruar vllahë të këtij rajoni nuk ka.

Studiuesi i kulturës dhe i gjuhës së rajonit nuk mund të lërë jashtë vëmendjes së tij tre libra të botuara në Shqipëri [Sadikaj 1999], në Maqedoni [Светиева 2006] dhe në Bullgari [Тончева 2009]; këto botime japin të dhëna tejet të çmuara dhe pasurojnë në mënyrë thelbësore njohuritë shkencore mbi Gollobordën. Këtu e kemi të pamundur të recensojmë me hollësi të tre librat, ndaj prej tyre po paraqesim shkurt atë më aktualin dhe më të pasurin me materiale. Në monografinë e Vesellka Tonçevës (2009) është përshkruar kultura tradicionale e Gollobordës: këngë folklorike, rite dhe botëkuptimi, kujtime dhe rrëfime vendase, fotografi. Komentet shkencore të autores mbi materialet e paraqitura prekin aspekte të rëndësishme të historisë, fesë, riteve, muzikës, identitetit dhe në përgjithësi të jetesës së “bullgarëve vendas”. Janë marrë për bazë dhe janë shqyrtuar shumica e botimeve shkencore mbi rajonin, me përjashtim të punimeve më të fundit të Xhelal Yllit [Ylli, Steinke 2008]. Monografia është ndërtuar mbi intervistat e regjistruara në fshatrat Steblevë, Klenjë dhe Vërnice, po ashtu janë intervistuar edhe banorë të shpërngulur nga fshatrat Steblevë dhe Klenjë në Tiranë²² e Durrës.²³ Theksohet braktisja e rajonit dhe migrimi në qytete, shkatërrimi i lidhjeve shoqërore, terreni i thyer dhe vështirësitë e punës. Në kapitullin për muzikën [Тончева 2009: 63—90] përshkruhet mungesa e diafonisë (dyzërave) në këngët e Gollobordës, ndërkohë që në muzikë janë tradicionale dy zurna dhe dy daulle me tingëllim diafonik. Në traditën vendase dallohen këngët e burrave (baladat dhe ato që këndohen rreth tavolinës) dhe këngët e grave (rituale). Kapitulli është plot me dëshmi që vërtetojnë se banorët “këndojnë këngë bullgare”, se “e duan shumë Bullgarinë”, që pohojnë se “këngët tona nuk janë si maqedonase”, dhe se banorët marrin pjesë

²² Në Tiranë rajonet e përqendrimit të të shpërngulurve nga Golloborda janë *Kodra e Priftit* dhe *Dogana*.

²³ Sllavët e jugut të Ballkanit Perëndimor e quajnë këtë qytet *Drač* (*Драч / Drač*).

në festivalet folklorike bullgare. Si një nga faktorët, që ka ndihmuar në “ruajtjen e popullsisë bullgare” në krahinë, përmendet “endogamia në grup sipas linjës etnike dhe fetare”.

Pavarësisht nga vlera e materialeve të librit, në veçanti e atyre muzikorë e folklorikë, vepra e Vesellka Tonçevës ka edhe mangësi të tilla thelbësore si përdorimi i metodologjisë së diskurseve postmoderniste,²⁴ njëanshmëria etnonacionale dhe qëllimi për të ndikuar te banorët gjatë intervistave. Në veçanti, shembujt e dhënë mbi “gjuhën e gjallë” [Тончева 2009: 129—295] përmbajnë jo vetëm mangësi, për shkak të regjistrimit joprofesional me përdorimin e cirilikes bullgare, por edhe karakterizohen haptazi nga tipari sugjestiv i bisedave të zhvilluara:

* * *

Spiro Marku:²⁵ *Идет Стеблево, Кленье, Гинеец, после идет Требица како село, Вормица, после Острени мало, Големо Острени...*

Vesellka Tonçeva: *Как му е името — Мали Острени?*

S. M. *Малиострени го викаме мие, Големо Острени, се две Острени — големо и мало.*

V. T. *А са близо Големо и Мало Острени?*

S. M. *Близу са, аки половина часа пеши. После от Мало Острени оиш во Тучепи, после влагаиш во Ладимерица, и тя село тука, Пасинки, по Пасинки Миреши, то е албанско.*

V. T. *Мене бугарските (кështu! — А. S.) ме интересуват.*

S. M. *Бугарските до Пасинки...*

V. T. *Колко са села, ги знаеи? Има 20 села?*

²⁴ Si te studiuesit maqedonas, po ashtu edhe tek ata bullgarë, shpesh në qendër të shqyrtimit jokritik vihet diskursi me të anketuarit, për shembull për “qytetin” (merret me mend, Dibrën), për “kufirin”, për “gjuhën” e kështu me radhë; në këto kushte rezultatet e studimeve bien ndesh me njëra-tjetrën.

²⁵ Për këtë të anketuar kemi këto të dhëna: Spiro Marku, lindur në 1956, nga Vërnica (V. Tonçeva).

S. M. *Види сега — Кленье едно, Стеблево две, Гиновец три, Требица наше село още четири, Вормица пет, Пасинки шест, Ладимерица седум, ове Ђрбеле осум, Кърчица девет...*

V. T. *А тия (Ђрбеле, Кърчица) къде са?*

S. M. *Кон Дебар са тия, кон Маќялари, кон Дебар.*

V. T. *А во Ђрбеле са исто христијани (kështu! — A.S.)?*

S. M. *Кристияни, мешани, поекъе кристияни, ама мешани.*

V. T. *Вормица е била само кристияни?*

S. M. *Само кристияни, те се измешаа...*

* * *

Mitre Rajko:²⁶ *...има, що велят Летник, велиме на четиринайсети марс.*

V. T. *Летник. Що значи? Що се прави?*

M. R. *Нищо се прави, се полюшкая джагуриња со, ке обеси на нешто, люлки.*

V. T. *А тука (kështu! — A. S.) врџва ли се (kështu! — A. S.) на децата (kështu! — A. S.) бяло и червено (kështu! — A. S.)?*

M. R. *По, џрвено и бело.*

V. T. *Как се вика?*

M. R. *Монякъ го викаме ние.*

Për sa i takon besimit fetar, thuhet se popullsia predikon krishterimin dhe islamin, ndërkaq myslimanët përbëjnë shumicën (në traditën bullgare ata i quajnë *българи мюсюлмани / bëllgari mysyllmani, българи мохамедани / bëllgari mohamedani*, kurse në atë maqedonase — *македонци муслимани / makedonci muslimani, торбеши / torbeshi*), dhe se është e vështirë të përcaktohet koha e saktë e pranimit të fesë islame, por ka mundësi që për pjesën më të madhe të popullsisë kjo të ketë ndodhur vetëm në shekullin XIX. Në kapitullin mbi vetëdijen [Тончева

²⁶ Për këtë të anketuar kemi këto të dhëna: Mitre Rajko, lindur në 1937, nga Stebleva (V. Tonçeva, K. Rangoçev).

2009: 91—117] ndeshim një përsëritje të herëpashershme, të pavenda dhe skolastike të konstruktit “identitet” (shumësi, hierarkizëm sipas strukturës, varietet, situacion dhe dinamizëm), si dhe një sërë tezash, të cilat shpalosin haptazi logjikën dhe qëllimet e vërteta të autores së librit. Pikërisht, duke u ngatërruar në interpretimet cilësore të nocionit thjesht sasior “pakicë” dhe në sajemat mbi “dallimet ndërmjet etnikes dhe nacionales”, Tonçeva e shpall “komunitetin bullgar të Gollobordës” jo pakicë nacionale, por pakicë etnike, “pasi (ata) kanë një ndjesi vetjake të bashkësisë së tyre” (f. 98).²⁷ “Epërsitë” e përfituara pikërisht nga kjo qasje diskursive, të kuptuarit e identitetit si një konstrukt që ndryshon sipas rrethanave dhe nuk përmban thelbin, shmangin çdo mundësi për objektivitet shkencor.

SLlavËT DHE SHQIPTARËT, MYSLIMANËT DHE ORTODOKSËT NË GOLLOBORDË

Andrea N. Sobolev

Nga literatura etnografike e shekullit XIX tashmë dihet mirëfilli se në *sanxhakun* e Dibrës kanë banuar shqiptarë myslimanë, shqiptarë ortodoksë, shqiptarë katolikë, sllavë myslimanë (të quajtur me ekzonimin *torbeshi*) dhe sllavë ortodoksë (atëherë të quajtur *serbë* ose *bullgarë*, ndërsa pas vitit 1945 dhe *maqedonas*; këto përcaktime etnonacionale, në varësi të prirjes së autorit, përdoren edhe për torbeshët); rindërtimi i raporteve të sakta sasiore ndërmjet këtyre grupeve në të kaluarën është shumë i vështirë, në mos i pamundur. Megjithëse në fundin e shekullit

²⁷ Vetidentifikimi si “maqedonas” gjoja sikur krijohet “nën ndikimin e propagandës së Republikës së sotme të Maqedonisë”. Vetëkuptohet se në parashtrimin e Tonçevës, banorët e Gollobordës “nuk kanë parë ndonjë të keqe” nga Bullgaria, por kanë hequr keq nga Serbia (sikurse dihet, ushtria serbe ka djegur fshatin Steblevë); madje del se edhe në gjuhën e Gollobordës nuk ka fjalë më të ndryrë se “сърби”: *лош како серб / loš kako serb* (pikërisht në këtë formë fonetike! — A. S.).

XIX dhe fillimin e shekullit XX marrëdhëniet sllavo-shqiptare në Maqedoninë Perëndimore, sipas të dhënave të konsujve dhe studiuesve rusë [Селишев 1929; 1931], nuk shquheshin për harmoni, për shekullin XXI është i vlefshëm konstatimi se: “Secili atje ka një ide mjaft të qartë për gjuhën e tij amtare, për përkatësinë fetare dhe identitetin etnik, por kjo nuk shpie drejt tensioneve në marrëdhëniet e ndërsjella” [Ylli, Steinke 2008: 24]. E megjithatë, studiuesit (gjuhëtarët dhe etnografët) nuk japin të dhëna sistematike mbi dallimet ndërmjet ortodoksëve dhe myslimanëve, ose dhe ndërmjet shqiptarëve dhe sllavëve. Për shembull, sipas të dhënave të shpërndara dhe jo të sistemuara të Filipoviqit, dallimet, përveç veshjeve [Филиповић 1940: 56—61], përmbledhen në sa vijon:

myslimanët për të treguar fisin (*фара / fara* ose *фис / fis*) përdorin edhe leksemën *кабиле / kabile*, ndërsa kur u drejtohen më të rriturve përdorin leksemën *миджо / mižo*;

ortodoksët përdorin *пипрон / pitrop* ‘kujdestar i kishës’, *мали пипрон / mali pitrop*, *пипроница / pitropica*;

shqiptarët kanë zakonet e gjakmarrjes, në fshat ka *plak* ose *plak lleu* (*dheu*), një lloj kujdestari, *полак / polak* ‘roja i pyllit’ quhej *derudexhi*, kurse mbledhja e pleqve në fshatrat shqiptare quhet *gjyç* (forma letrare *gjuç*).

Në literaturën mbi rajonin, që ende mund të shqyrtohet me lehtësi, paraardhësit tanë kanë bërë një varg vëzhgimesh interesante, për shembull: që “terminologjia e farefnisnës... praktikisht është e tëra sllave”, me korrigjimet e njohura duke marrë për bazë veçoritë e së folmes së myslimanëve (për shembull, *ала / ala* ‘motra e babait’, *тетка / tetka* ‘motra e nënës’, *кушерин / kušerin* = *братучед / bratučed*, *стар бабо / star babo* ‘gjuçsh’, *бир мамин / bir tamin* me përdorim thirrës, *биразеп / birazer* // *биразел / birazel* ‘vëllam’). Ndërkaq, edhe vetë të anketuarit tregojnë mbi dallimet në terminologjinë e grupeve fetare: “Ne themi kështu, kurse të krishterët ashtu”; grupet e përkundërta leksikore të këtij lloji i gjejmë në çiftet *бабо / babo* ~ *татко / tatko*, *мицо / mižo* ~ *чичко / čičko*, *дајо / dajo* ~ *вужко / vučko* [Велковска 2011: 59—63].

Për ortodoksët në Gollobordë flitet në një libër të vogël amator të Kristofor Bedulit [Beduli 2008]. Përveç të dhënave mbi harmoninë e plotë e të mrekullueshme ndërmjet përfaqësuesve të të dyja besimeve të këtushme, mbi mungesën në çdo kohë të konflikteve me bazë fetare, për ne flet edhe tregimi mallëngjyes lidhur me shërbesën e priftit autodidakt *papa Todi Pleushku* (lindur në vitin 1918) nga Klenja, i cili e zhvillonte shërbesën në gjuhën shqipe dhe sllave deri në vitin 1968 dhe pas vitit 1989 [Beduli 2008: 12 v.]. Është domethënëse dinamika e zvogëlimit të popullsisë ortodokse në fshatrat e Gollobordës në gjysmën e dytë të shekullit XX:

Fshati	Numri i banorëve ortodoksë		
	1950	1998	2008
<i>Klenjë</i>	25	12	2
<i>Vërnica</i>	42	3	1
<i>Herbel</i>	12	8	2
<i>Pasinka</i>	12	9	4
<i>Gjinoveci</i> ²⁸	18	2	
<i>Steblevë</i>	14	7	4
<i>Ostren i Vogël</i>	12		
<i>Trebisht</i>	4		
<i>Kërçisht i Sipërm</i>	15	7	4
<i>Gjithsej</i>	154	48	17

Vëzhgime të sakta, të drejtpërdrejta e të besueshme, mbi bashkekzistencën e komponentëve shqiptarë e sllavë në fshatrat e rajonit janë realizuar vetëm në fillim të shekullit XXI. Për entuziastët e angazhuar nacionalistë shqiptarë, maqedonas a bullgarë, nuk ka pasur probleme të mëdha me etiketimin e grupeve të popullsisë së Gollobordës. Përkundrazi, ndërlikimet e atribuimit etnik të popullsisë i kanë detyruar studiuesit, të cilët e kanë njohur situatën me hollësi,

²⁸ Kështu është shënuar në burimin origjinal.

të përdorin përcaktimin greqisht “sllavofon” (d.m.th. sllavishtfolës) si neutral dhe që nuk ka lidhje me shqiptarët dhe sllavët e më tej me serbët, bullgarët ose maqedonasit [Ylli, Steinke 2008: 10, shënimi 10; 24 v.]. Analiza e regjistrimit të popullsisë në Shqipëri bën të mundur llogaritjen e numrit të përafërt të banorëve në fshatrat me popullsi sllavishtfolëse për vitin 1989: rreth 10 mijë vetë [Ylli, Steinke 2008: 20]. Vitaliteti mahnitës i këtij grupi, që nuk e ka braktisur gjuhën e vet, mund të shpjegohet me statusin e veçantë administrativ të këtij rajoni deri në vitin 1989 si një zonë e mbyllur kufitare, e për më tepër me faktin se nuk ka qenë tërheqës për jetesë. E megjithatë në çdo fshat ka pasardhës të personave të shpërngulur nga Shqipëria e Mesme, mbi gjuhën fillestare të të cilëve ne nuk dimë asgjë. Në martesat e përziera në Gollobordë partneri që nuk fliste sllavisht shumë shpejt integrohej në mjedisin sllavishtfolës, pavarësisht nga mungesa e ndonjë statusi zyrtar të së folmes sllave këtu. Shumica e sllavishtfolësve në Gollobordë zotëron në mënyrë aktive edhe gjuhën shqipe (dhe nuk bëhet fjalë për dialektin e gegërishtes qendrore të kësaj gjuhe në atë formë, të cilën ne e gjejmë te popullsia vendase shqipfolëse, për shembull në fshatin Borovë); për të zgjidhur çështjen e formës së ligjërimit shqip të sllavëve të Gollobordës nevojiten studime të veçanta.²⁹ Në fshatin Trebisht midis të anketuarve tanë sllavishtfolës ka pasur persona të seksit femëror me moshë mesatare dhe të shkuar që nuk flisnin (ose flisnin fare pak) shqip;

²⁹ Duke pasur pikërisht dëshirën për të demonstruar autoktoninë e sllavëve të Gollobordës, shkencëtarët e vendeve sllave zakonisht pohojnë se banorët sllavishtfolës të Gollobordës flasin më mirë në gjuhën letrare shqipe sesa në dialektin vendor gegë, ndërkohë që kolegët shqiptarë mendojnë të kundërtën, çka nënkupton autoktoninë këtu të popullsisë shqiptare gege. Ylli nga njëra anë ka të drejtë kur pohon se në ligjërimit shqip të “sllavofonëve” ndeshen forma gege, por nga ana tjetër, madje edhe nga një shikim i përciptë i të folmeve shqipe të Dibrës bindemi se çështja e llojit të dialektit geg të përdorur, mbetet e koklavitur. Për shembull, në materialet e Yllit ka, në dukje, forma jogege *mbesi* ‘mbesë’ [Ylli, Steinke 2008: 36], por, siç tregojnë hartat e Bahri Becit dhe Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe, fati i *mb*-së në nëndialektet e Dibrës shpesh dallon nga “mbarëgegërishtja”, deri te ruajtja e këtij grupi.

si dhe fëmijë që deri në moshën 7 vjeçe dinin vetëm një gjuhë. Mund të pohojmë me siguri se rezultatet e studimit varen shumë nga zgjedhja e rrethit të të anketuarve.

Teoritë shqiptare të etnogjenezës së popullsisë së Gollobordës. Në ndryshim nga maqedonasit ortodoksë të rajonit të Prespës, sllavët myslimanë dhe ortodoksët e paktë të Gollobordës (si dhe goranët-myslimanë në rajonin e Gorës) nuk kanë në Shqipëri statusin zyrtar ligjor të pakicës kombëtare. Disa iniciativa kulturore e iluministe të entuziastëve vendas dhe nga kryeqyteti, po ashtu dhe përpjekjet për të përfshirë sllavët myslimanë në veprimtaritë politike të partive maqedonase në Shqipëri, nuk kanë lënë gjurmë të thella në peizazhin kulturor dhe gjuhësor të rajonit. E folmja sllave vendase përdoret vetëm në të folurën e përditshme (dhe, merret me mend, për të komunikuar në Republikën fqinje të Maqedonisë) dhe nuk “mbulohet” zyrtarisht nga asnjë prej normave bashkëkohore sllavojugore; toponimia zyrtare është në formën shqipe (p.sh. Lejçan, Trebisht), ndërsa në të folurën e përditshme të popullsisë vendase përdoret në formën sllave (*Лешничани / Lešničani, Требишта / Trebišta*).

Në literaturën enciklopedike, të njohjes së vendit, ndonjëherë edhe në atë specifike shkencore shqipe, fakti i pranisë së popullsisë sllavishtfolëse në rajonin e Gollobordës ose thjesht lihet në heshtje [Lafe et al. 2008], ose ndërtohen teori mjaft fantastike të etno- dhe lingogjenezës së tij. Kështu, duke iu referuar idesë pseudoshkencore të prejardhjes së tyre bogomilase (dhe, rrjedhimisht sipas paradigmës së sotme kvazishkencore, prejardhjes sllavo-bullgare), Hilmi Sadikaj [Sadikaj 1999: 57, 64] ngre konceptin, sipas të cilit në Mesjetë në zonën e Gollobordës të rajonit të Dibrës ka banuar një popullsi autoktone arbëreshe, e cila nën veprimin e qëllimshëm asimilues (me sa duket të shteteve sllave, dhe, para së gjithash, të mbretërive Bullgare) ka pranuar “ngarkesa konvencionale ortodokse” dhe dygjuhësinë shqiptaro-bullgare. Në këtë mënyrë arbëreshët shqipfolës përfituan njohuritë e gjuhës bullgare, “një zhargon i sajuar, i cili me kalimin e kohës u bë gjuhë e familjes”, dhe morën fenë ortodokse për të shmangur islamizimin. Në

këtë konstruksion nuk lihen pa u përmendur edhe bogomilët, gjoja sipas një përcaktimi të përgjithshëm të tyre, bullgarishtfolës [Sadikaj 1999: 64, 68]. Në etnogjenezën e Gollobordës, sipas këtij autori, kanë marrë pjesë këto grupe: shqiptarët katolikë (autoktonë dhe të shpërngulur nga perëndimi), aktualisht të asimiluar; shqiptarët ortodoksë (nga shqiptarët katolikë që morën fenë ortodokse si pasojë e vendosjes pranë të sllavëve të paktë ortodoksë dhe për t'i rezistuar islamizimit); shqiptarët myslimanë (të shndërruar nga shqiptarët katolikë të rajoneve perëndimore, nga shqiptarët katolikë vendas, nga shqiptarët ortodoksë vendas); shqiptarët myslimanë dygjuhësh; dhe, më në fund, sllavët ortodoksë (të shpërngulur nga lindja).

Konvergenca dhe divergenca. Një vlerë të madhe njohëse do të sillte përgjigjja për çështjen nëse rajoni i Dibrës dhe i Gollobordës ka qenë një vend i konvergencës etnike, gjuhësore e kulturore në të kaluarën dhe nëse është i tillë edhe sot. Historikisht dhe njëkohësisht banorët shqip- dhe sllavishtfolës të rajonit kanë përfaqësuar grupe gjuhësore që dallohen qartazi nga njëri-tjetri, dhe në këtë kuptim është i saktë përcaktimi i tyre përkatësisht si shqiptarë të Gollobordës dhe sllavë të Golo Bordo. Po ashtu historikisht dhe sinkronikisht të krishterët (ortodoksë) dhe myslimanët sunnitë të rajonit kanë përfaqësuar grupe fetare që janë qartazi të ndarë nga njëri-tjetri, dhe në këtë kuptim përcaktimet përkatëse janë të vërteta.

Konvergenca gjuhësore mund të ndodhë kur një zonë ende flet gjuhën fillestare (e cila i nënshtrohet ndikimit leksikor, morfologjik dhe fonetik), si dhe në formën e ndryshimit gjuhësor (të kalimit të një pjese periferike të bashkësisë shqipfolëse në gjuhën sllave, kurse i asaj sllavishtfolëse në gjuhën shqipe). Konvergenca etnike vihet re ndërmjet përfaqësuesve të popullsisë myslimane shqiptare dhe sllave: si faktorë themelore të saj janë feja e njëjtë (islami sunnit), njohja e gjuhës shqipe nga sllavishtfolësit, besnikëria ndaj kulturës dhe shtetësisë shqiptare.

Përfytyrimi i përgjithshëm për rajonin e Dibrës dhe mikrorajonin e Gollobordës si një vend i konvergencës kulturore, linguistike dhe etnike, duhet t'i nënshtrohet një korrigjimi thelbësor. Ndarja e grupeve

të njerëzve sipas tipareve fetare³⁰ dhe gjuhësore këtu ka po të njëjtën vlerë sa edhe gjithkund, ndërkohë që rruga e vetme e mënjanimi të kundërshtive, përveç emigrimit, mbetet përfshirja e individit në grupin mbizotërues dhe më me prestigj. Integrimi i suksesshëm bëhet i mundur vetëm nëse hiqet dorë nga etiketimet, të cilat konsiderohen si “të huaja”, duke patur parasysh që numri i tyre vështirë të përcaktohet.

Divergjenca vihet re ndërmjet përfaqësuesve të grupeve të ndryshme fetare dhe më qartë se askund shfaqet te largimi pothuaj i të gjithë ortodoksëve nga rajoni.

FSHATRAT E MARRA NË STUDIM

Andrea N. Sobolev

Përderisa faktorët themelorë të ndarjes dhe të bashkimit të grupeve të popullsisë së Gollobordës janë gjuha (shqipe dhe sllave) dhe besimi fetar (islami dhe ortodoksia, me një peshë specifike minimale katolikësh shqiptarë), atëherë për ndërtimin e një harte shpjeguese mbi rajonin

³⁰ Shembuj “të mirëkuptimit dhe jetesës së përbashkët ndërmjet etnoseve dhe konfesioneve” në Gollobordë reduktohen në sa vijon: në vitet e luftës myslimanët dhe të krishterët kanë organizuar mbrojtje të përbashkët të fshatrave të tyre; ortodoksët nuk mbajnë derra për të mos fyer myslimanët dhe për të mos humbur mundësinë për t’i ftuar ata në shtëpi; në dasma ftojnë përfaqësuesit e besimit tjetër dhe u bëjnë atyre nderime të veçanta, për shembull, i lënë të heqin vallen; grindjet ndërmjet fëmijëve i zgjidhin të rriturit në frymën e paqes; përfaqësuesit e të dyja besimeve së bashku kanë ndërtuar rrugë e ura në rajon; në rajon jetojnë romë (që identifikojnë vetën si “egjiptianë”) [Цварку 2006: 63—64]. Krahaso me tekstin e regjistruar nga V. Tonçeva: *Радост, ядост, яденье, пиенье, свадби, рожачка, умирачка — све заедно... Никогаш на век мие не сме правели вака да се караме. Ти ортодокс — я мюслиман. Свите стеблевски си ворвят како братя и сестри — ристияни и мюслимани... За мльогу годин Великоден кай ристияниве, за мльогу годин Байрам кай мюслиманите. Свите заедно* [Tonçeva 2009].

dhe popullsinë e tij ishte i domosdoshëm hulumtimi i jetesës në pika të ndryshme të zonës: në fshatrat Trebisht (*Требишта* / *Trebišta*; me popullsi myslimane sllavishtfolëse), Klenjë dhe Vërnice (*Клење* / *Klenje* dhe *Вор(б)ница* / *Vor(b)nica*; të dyja me popullsi të përzier myslimane dhe ortodokse sllavishtfolëse) dhe, më në fund, Borovë (*Борово* / *Borovo*; me popullsi myslimane shqiptare). Të dhëna mjaft të sakta dhe të besueshme për këto fshatra në vitet 1930 të shekullit XX gjenden në veprën e etnografit serb Milenko Filipoviq, i cili i ka mbledhur ato nga bisedat me të anketuarit në pjesën e atëhershme jugosllave të Gollobordës [Филиповић 1940: 36—38]; më poshtë po i paraqesim këto të dhëna duke i plotësuar ato me të tjera, përfshi këtu dhe të dhënat tona.

Trebishti (Требишта / Trebišta). Trebishti, një fshat tashmë krejtësisht mysliman dhe sllavishtfolës, përbëhet afërsisht nga 1000 banorë, gjithë-gjithë rreth 150 shtëpi.³¹ Ai ndodhet mu në kufi me Maqedoninë në lartësinë 800 metra mbi nivelin e detit, kurse livadhet alpine, që u përkasin banorëve të tij, gjenden në lartësi deri 1500 metra dhe aty shkohet me mushka dhe me kuaj (shih ilustrimet). Trebishti është qendra e komunës, në të cilën tani ka një shkollë 9-vjeçare, ndërsa më parë ka pasur gjimnaz, shkollë mbrëmjeje dhe një shkollë bujqësore.³² Zanatet kryesore të popullsisë janë ai i ndërtuesit sezonal

³¹ Hulumtimi i historisë së fiseve të fshatit të sjell në përfundimin se midis sllavishtfolësve të sotëm ka pasardhës të popullsisë dikur shqipfolëse, të migruar në Gollobordë: “Fisi Sadikaj: Edhe ky fis, për arsye se ka pasur shtesë njerëzore, ka dalë nga fshati Zajaz i Kërçovës dhe është vendosur në fshatin Trebisht-Çelebi. Në këtë fshat ky fis mund të ketë ardhur, vet i pesti vëlla, rreth fundit të shekullit XVIII. I pari i fisit ka qenë Fido Sadiku dhe kryente funksionin e bylykbashit në shërbim të agallarëve të Shehrit të Dibrës, në fshatin Trebisht-Çelebi. Gruan e vet e kishte marrë tek fisi Ajazi i Trebisht-Balasë, të ardhur nga Lura e ish-in shqipfolës (Sadik Fido Sadikaj, vjeç 90, nga fshati Trebisht, intervistë e vitit 1990)” [Sadikaj 1999: 100—101].

³² Në fshat krenohen me bashkëfshatarët që kanë bërë karrierë në kryeqytetin e vendit. Tregojnë se ministri i arsimit Meqir (Myqerem) Tafaj e ka origjinën nga lagjja Muçinë (*Мучина* / *Mučina*) e Trebishtit.

në Shqipëri, Greqi³³ dhe Maqedoni (*g'urbet*),³⁴ ai i bujqësisë (kultivohen kryesisht *č'enki*, n. sh. 'misër' dhe *k'ompir* 'patate'), si dhe mbarështimi i bagëtive të imëta dhe të trasha, mullinj të, kafenetë dhe dyqanet. Fshati, ku rregullisht organizohet pazari, mund të konsiderohet si qendër ekonomike e krahinës. Sipas të dhënave të Aneta Svetievës, në fshatin Trebisht më parë praktikoheshin endogamia brenda fshatit [Светиева 2006: 10]. Në tetorin e vitit 2009 Ylli Halili hapi në fshat një klasë private të gjuhës maqedonase, në të cilën u jepte mësim rreth 15 nxënësve; pas një viti klasa, sipas gjithë gjasave, u shpërnda.

Fshati Trebisht ishte vendi bazë në të cilin jetuam dhe punuam. Ekzistenca e gjallë e kulturës arkaike tradicionale dhe e folmja që nuk mbulohet nga asnjë prej normave letrare sllave, bën që studiuesi i cili punon në Trebisht, të ndihet në “një rezervat etnografik dhe gjuhësor”.

Sipas të dhënave të Filipoviqit, në Trebisht në vitet 1930 kishte rreth 700—800 shtëpi, prej tyre vetëm 3—4 ortodokse (në vendin e quajtur *На Чуфлик / Na Čiflik*). Në vendin *Црквиште / Crkvište, Црков / Crkov*,³⁵ mu te kufiri i sotëm shtetëror, ishte edhe një varrezë ortodokse, por “vitet e fundit (e përsërisim bëhet fjalë për vitet 1930. — A. S.) myslimanët po heqin shenjat nga varret e krishtera”. Një pjesë e mikrotoponimeve (*Рамна гора / Ramna Gora, Бела Вода / Bela Voda, Острени / Ostreni, Пресека / Preseka, Радичево Гумно / Radičevo Gumno, Нејновешица / Nejnovešica, Ветерник / Veternik, Јастребац / Jastrebac, Суа Река / Sua Reka, Којоска Бука / Kojoska Buка, Трештуца*

³³ Për shembull, muratorët e punës me gur, që në vitin 2008 punonin në Greqi, merrnin 55 euro për një metër katror mur.

³⁴ Tregojnë se më parë në *g'urbet* shkonin më këmbë në Selanik (të ashtuquajturit *gurb'etčii solunž'i:te*); kur ktheheshin floringj të e fituar i fshihnin në bishtat e sëpatave, ku kishin bërë zgavra.

³⁵ Krahaso: *Corkof se vikat mestoto, ama corkva ne* [Ylli, Steinke 2008: 231]. Kisha i ishte dedikuar Shën Parashqevisë (së Premtes). Dëshmi për gjurmët e ortodoksisë në fshatin Trebisht jepen edhe në [Тончева 2009]: toponimet *Ѓорѓиџе / Ğorgijče, Марко куки / Marko kuki, каурски ниви / kaurski nivi* dhe madje edhe emrat e përveçëm *Стојан / Stojan, Борис / Boris, Алексо / Alekso*.

/ *Treštica*, *Гару* / *Gari*, *Кољов Вур* / *Koljov Vir*, *Торец* / *Torec* (çezmë), *Вранель* / *Vranelj*, *Царевец* / *Carevec*, *Мета* / *Meta* (*Метова* / *Metova*), *Рен* / *Ren*), janë krijuar nga emra të përveçëm të krishterësh.³⁶ Edhe sot e kësaj dite banorët e fshatit flasin për gjurmët e popullsisë ortodokse, duke përsëritur pak a shumë ato që janë thënë edhe në vitet 1930 [Beduli 2008: 21—22 v.]: në vitin 1950 në fshat kishte ende katër familje ortodokse: gurin në lagjen Muçina (*Мучин(а)* / *Mučin(a)*), që ka mbetur në vendin e kishës së rrënuar, e nderojnë edhe ortodoksët, edhe myslimanët; “në fshat ka një vend që quhet *Kauri*... Ka pasur katër shtëpi ortodoksësh... Njëri nga ata quhej *Ivan Bogushi*... Ne në fshat kemi fisin *Koçi*... Një nga rajonet mbi lagjen Bala quhet *Koçoski*, *Koçoska Buka*...”.

Klenjë (Клене / Klenje). Në fshat aktualisht ka më pak se 150 banorë, prej të cilëve një numër i vogël janë ortodoksë. Sipas të dhënave të Filipoviqit, në vitet 1930 këtu banonin 130 familje në 100 shtëpi, ndërkohë që në të njëjtën shtëpi, mund të jetonin edhe ortodoksë, edhe myslimanë. Në vitin 1939 fshati kishte 40 familje ortodoksësh, shumë nga anëtarët e të cilave merreshin me punë sezonale si rrobaqepës (*терзун* / *terzii*, n. sh.) dhe qepnin në fshatrat e zonës rroba leshi. Në

³⁶ Filipoviqi tregon një legjendë të vjetër lidhur me kalimin e banorëve të fshatit Trebisht në fenë islame: Dikur, kohë më parë, erdhi në Trebisht peshkopi dhe atë e morën në shtëpi jo të krishterët, por një mysliman, dhe peshkopi e mallkoi fshatin, duke uruar “që aty të kishte aq myslimanë, sa ka tani të krishterë, dhe të krishterë, aq sa ka sot myslimanë”. Filipoviqi ka botuar dhe një anekdotë sesi një hoxhë i paarsimuar i Trebishtit kishte thënë në varrim tekstualisht *Буђун бирису, јарн енуцу* (*Buđün birisi, yarin episi*) “sot njërin, kurse nesër të gjithë”. Në kopjen e librit të Filipoviqit në Bibliotekën Kombëtare të Serbisë në Beograd në këtë vend me germa latine është shkruar vërejtja e një lexuesi të zemëruar: *totalna laž!* Nga vrojtimit që kemi bërë ne lidhur me islamin këtu, ndalimet e njohura respektohen nga myslimanët vendas me shkallë të ndryshme rigoroziteti. Kështu, rakinë burrat e pinë çdo ditë nga ora 7—8 deri në orën 12 paradite dhe në mbrëmje, përfshirë edhe agjërimin e ramazanit; por për sa u takon derrave thonë me pësitrosje se “të tillë nuk mbahen”: *t'akfi ne d'oržime!*

fshat ishte kisha e Shën Nikollës, si dhe rrënojat e kishës së Shën Petkës. Fiseve ortodokse u takonin *Ниновци / Ninovci, Мазниковци / Maznikovci, Пљаушковци / Pl'auškovci, Мирчевци / Mirčevci, Будиновци / Budinovci, Филоћовци / Filoćovci, Огненовци / Огненовци, Бошковци / Boškovci (Бушковци / Buškovci)*. Ndërsa fiseve myslimane u takonin: *Касовци / Kasovci, Ниновци / Ninovci* (degë e ortodoksëve *Ниновци / Ninovci*), *Димовци / Dimovci*. Të dëgjuar ishin edhe *Јаганца клењска / Јаганца клен'ска* (këshu jepet te Filipoviqi!), *планина стеблевска / planina steblevska*. Sipas informatave që kemi ne nga Trebishti, në Klenjë edhe sot e kësaj dite festohet *Божик / Božik* (d.m.th. 'Krishtlindja') dhe ka *гайдаджия / gajdažija* (d.m.th. 'gajdexhi').

Vërnice (Вор(б)ница / Vor(b)nica). Është një fshat me më pak se 30 banorë, njëri prej të cilëve ortodoks (shih të dhënat statistikore në [Ylli, Steinke 2008: 11, 160, 227, 241]). Aty është edhe kisha e Shën Nikollës. Sipas Spiro Markut, ortodoksit të vetëm në fshat, i cili është intervistuar absolutisht nga të gjithë ata që kanë vizituar Gollobordën vitet e fundit, më përpara fshati ka pasur deri 80 shtëpi, tani kanë mbetur vetëm dy, mbasi njerëzit kanë shkuar të jetojnë në Elbasan dhe në Tiranë. Spirua është martuar me një myslimane nga fshati Ostren; familja e tij në vitin 2008 mbante 14 dele dhe 2 lopë.

Borovë (Борово / Borovo). Fshat shqiptar, i cili sipas gojëdhënës është themeluar nga çobenj vllahë, në vitet 1930 numëronte rreth 100 shtëpi. Në defterin osman të vitit 1467 përmendet në fshat pronari i timareve, Ali Uzgur, dhe 27 familje fshatare.

Nuk është e qartë se çfarë e ka shtyrë Filipoviqin të bëjë një vërejtje krejtësisht të gabuar, sipas së cilës në këtë fshat "shqiptarët edhe sot nuk e flasin shqipen pastër, por e përziejnë"; më saktë i pasqyron karakteristikat e shqipes së këtushme autori bashkëkohor shqiptar [Sadikaj 1999: 125], i cili ka mendimin se me pastërtinë dhe muzikalitetin e saj të veçantë, ajo është e afërt me karakteristikat e së folmes së Elbasanit. Në fiset Çermenika, Mjekërmadhi, Ceta dhe Hysendemiraj autori shqiptar, Hilmi Sadikaj, parapëlqen të shohë "një shtresë etnike arbërore" të vjetër të fshatit, d.m.th. katolikë tashmë të islamizuar. Familjet e tjera të fshatit, sipas të dhënave të tij, janë të

ardhura. Nga rrethi i Matit: fiset Caka, Mali, Musta, Isaku, Cani; nga zona e Gurit të Bardhë në rrethin e Matit — Beqiri, Cara; nga zona e Macukullit të rrethit të Matit — Isaku, Cani; nga krahina e Neshtës e rajonit të Librazhdit — Curri, Zeneli, Sulaj; nga krahina e Çermenikës — Alcanajt, Abazajt. Nuk dihet origjina e fiseve Balla, Golli, Alla, Hysi, dhe Hasi [Sadikaj 1999: 124—125].

SLlavËt e GOLLOBORDËs

GJUHA

FONETIKA DHE GRAMATIKA

Andrea N. Sobolev

Vërejtje paraprake.³⁷ Nevoja për të paraqitur pak më poshtë disa të dhëna gjuhësore, të cilat nga pikëpamja e sllavistikës dhe maqedonistikës janë fare të zakonshme, ka lindur prej dyshimeve që ka një pjesë e publikut shqiptar lidhur me aftësinë e mjaftueshme gjuhësore të banorëve të Gollobordës për t'u shprehur në idiomën e tyre amtare sllave. Këto dyshime, të paktën për sa i takon ligjërimit të të anketuarve tanë në fshatin Trebisht dhe të një rrethi të gjerë të banorëve të fshatrave të tjera të marra në studim, nuk kanë vlerë, edhe pse ndikimi i shqipes mbi këtë ligjërim është i dukshëm.³⁸ Në planin më të përgjithshëm për të folmen mund të thuhet se ajo jo vetëm është plotësisht vitale, por dhe zotëron të gjitha karakteristikat tipike të gjuhës maqedonase, përfshirë dhe ato dialektore. Për arsye objektive

³⁷ Ky kapitull është botuar si artikull i veçantë [Соболев 2012].

³⁸ Ndikimi i shqipes, nëse gjykojmë nga materialet e Yllit, përfshin nga huazimet leksikore dhe leksikogramatikore (*djath*, *gjyshot*, *važdovjame*, *përdorvame*, *ose*, *sepse*; *do kopaš temeli be*) deri te kopjimi kalk i konstruksioneve gramatikore (*i na toj den G'urg'evden ode žene vo celevo bez deleni se ot vera*) [Ylli, Steinke 2008: 35—38].

përshkrimi, që parashtrohet më poshtë, nuk është i plotë, por, së bashku me të dhënat e paraardhësve tanë, ai na afron te njohja dhe kuptimi jo vetëm i strukturës së përgjithshme të së folmes, por edhe i shumë anëve të veçanta të saj.

Shkalla e ndryshueshmërisë në ligjërimin e të anketuarve, sipas vëzhgimeve tona, është shumë e lartë. Megjithatë, duhet të nënvizojmë se në përshkrimin e paraardhësve tanë e folmja ndonjëherë paraqitet disi më e përzier, nga sa ajo është në të vërtetë.³⁹

Me të anketuarit nuk kemi zhvilluar intervista të posaçme sipas pyetësorëve fonetikë dhe gramatikorë, por materiali gjuhësor i publikuar është përfutur nga ligjërimi spontan i mbartësve të së folmes, transkriptimi i të cilit jepet më poshtë. Në botim është përdorur transkriptimi i Atlasit linguistik mbarësllav. Dublinet dhe variantet jepen nën shenjën //. Kategoritë gramatikore dhe përkthimi i leksemës në gjuhën shqipe jepen vetëm atëherë, kur identifikimi i formës dhe i kuptimit nuk është shumë i qartë për lexuesin.

Mbi theksin. Theksi i kësaj të folmeje është preparoksiton, duke funksionuar si brenda leksemës (*k'opito*, *kop'itoto*; *p'ustin'a*; *star'icata*), ashtu edhe në kombinimet gramatikore të leksemave kuptimplota me njëra-tjetrën (për shembull, në togëfjalëshin atributiv: *v'eçerta*, por *drugat'a veçer*; *ot drug'i'ot mesec*) dhe në lidhjet e saj me klitikat (parafjalë: *ne: go d'ava so p'ari*, *b'es pari*; *go d'eram s'o roci*; *n'a corkof*; *pr'et sonce*; pjesëz mohuese: *i 'oko n'e faštaš n'ikoj pot*; *'ama ti n'e znaež da k'ažeš*; trajtë e shkurtër e përemrit: *što će m'u pra:m s'ega*; *ne s'e plašit ta: n'išto*). Janë vërejtur shmangie të motivuara nga mekanizmi i përgjithshëm, p.sh. pamundësia e theksimit të lidhëzës *da* (*da z'emat*) ose vendi etimologjikisht korrekt i theksit në disa huazime (*dem'ek*, *žen'aze*; *mot'orče*), por mes shmangieve më shpesh ndeshet ruajtja e

³⁹ Në veçanti, për shembull, edhe sepse në cilësinë e refleksëve **tj* gabimisht jepen forma që përmbajnë **sti*₂, **ski*₂, **dъsk* dhe **čyto*: *tr'ebišta*, *s'ebišta*, *p'uščeno*, *ogn'išteto*, *zašto*, *štiča*, *n'ešča*, *n'iščo* [Ylli, Steinke 2008: 57—58], ose në mënyrë jo bindëse postulohet forma e vetës së tretë n. sh. e foljes 'jam' *ije* krahas me të zakonshmen *se* [Ylli, Steinke 2008: 106, 109].

vendit të theksit për analogji me format e tjera të leksemës konkrete (*do 'oči; n'osal'ka* dhe *n'osal'kata, n'osal'kava; k'otn'ici* dhe *k'otn'icite; t'arbuška:* dhe *t'arbuškata; č'ereva* dhe *č'erevata*, por dhe *čer'evana; mom'ičin'ata*). Në shumicën, në mos në të gjitha rastet e tilla, janë të mundshme lëkundjet si *gr'odi // n'a grodi; t'enek'e // tenek'eto*. Prapëseprapë, disa shmangie duken të pamotivuara (*kor'ita, pom'in'it, rasto'ari, sen'oto, zaf'ati*) dhe meritojnë një studim më të hollësishëm në të ardhmen.

Mbi fonetikën historike dhe disa çështje të fonologjisë. Refleksat e **tj* në të folme janë të larmishme: *n'iškula; f'aštaše, z'afašta; pl'aštame; se tr'oštaet; id'e:šti; štī: pl'aštame rr'uğa, štī im d'avame;* ka mundësi, në toponimin *r'adoš;* por edhe *k'uća:; vr'eći; n'ok'e // n'oće, sv'onoć; v'eći, p'oeće; ća m'otime;* gjithashtu në fjalët *str'ečno; str'ečn'iot č'obek; str'ečen.* Diçka më e vogël është shtrirja e refleksëve në rastin e **dj*: *p'aždat, p'aždal, 'ispaždat; r'oždat, r'oždaet; na'oždaše, v'aždame; v'iždaš,* por edhe *v'ag'am, v'ag'ame.* Duket qartë që një pjesë e tyre është leksikalizuar, një pjesë, ka gjasa, është shfaqur nën ndikimin e dialekteve, ndërsa refleksat bazike -*št-* dhe -*žd-* në foljet mbarësllave janë specializuar si tregues të aspektit të pakryer.

Në fushën e vokalizmit është interesante çështja e statusit fonologjik [ɛ], [ɔ], [ə], [ɐ], për zgjidhjen e të cilit duhen bërë studime të posaçme.⁴⁰

Refleksi i hundores **ĭ* për habi është i qëndrueshëm (ka raste të shkëputura me [ə] si në *š'uma od d'əbot*), nëse nuk merren parasysh variantet fonetike [o] ~ [ɔ]: *dop // dɔp; gl'obi* v. 3, n. nj. 'mbytem, fundosem'; *gos; gr'odite; r'oka, s'o roci; k'osn'it, k'osn'iš, sk'osime; k'otn'icite; m'odin'a; m'otkata* t. shq. 'dybek'; *m'oško; 'oskope* v. 3, n. nj., aor. 'shtrenjtohem'; *p'otče, n'ikoĭ pot; s'odot* t. shq. 'enë';

⁴⁰ Materiali ynë është i pamjaftueshëm për zgjidhjen përfundimtare të kësaj çështjeje. Sjellim këtu një varg shembujsh të [ə] së theksuar: *m'ajk'i n'aši rab'ote:; s'alte; tr'əndafil'* 'trëndafil'; *t'əzdici* n. sh. 'e vërtetë'; një shembull i veçantë *nar'əčame* v. 1, n. sh. (*i će a nar'əčame, da 'imame ub'aina, str'eća*). Të krijohet përshtypja se për realizimin e [ə] nuk është indiferente prania e rrethimit zanor (sikurse ka vend kjo në të folmet jugperëndimore të gjuhës maqedonase *znəm < znam* v. 1, n. nj. 'di').

str'oga; *vn'otre* // *vn'otre*, *n'otra*.; *z'obi*, *z'opčin'a*; khs. gjithashtu *j'odrej* ‘janar’.⁴¹ Megjithatë, zhvillim të veçantë, ndonjëherë të leksikalizuar gjejmë në: *b'ubrek*; *k'uk'i*; *pr'uće*; më tej në: *'obrač*; *v'aper*; *vn'atre*, dhe, pa tjetër, në *ča b'idit* v. 3, n. nj., ardh. ‘jam’; kurse të gramatikalizuar e gjejmë në prapashtesën foljore që tregon një veprim, i cili kryhet një herë: *t'ornaf*, *sk'oknal*, *sl'ušnal* etj.

Hundorja **ç* ka refleks të natyrshëm në shumicën absolute të pozicioneve (*č'edo*; *st'egn'i!*; *ž'etvar*), përveç rastit kur ndodhet pas palataleve duke u përputhur me refleksin e **ĭ* (khs. *j'ože*; *joğl'enčina* dhe *j'ozik*, *j'ozikot*).

Reflekset tipike të zanoreve të reduktuara parasllave **ɔ* > *o*, **ɔ* > *e* dhe të të ashtuquajturave “ere të dyta” na lejojnë ta fusim të folmen tonë në vijimësinë dialektore maqedonase, khs. *boz*; *d'oždoi*; *mu se kl'apilo f's'one*; *r'ekol*; *n'a corkof*; *p'esok*; *'ogon*, nga njëra anë, dhe *d'en'e*, *d'eneska*, *v'ezden*; *l'en'ista*; *pēs*; *t'emna*; *'eden*, *t'ežeg*, *p'etel*, — nga ana tjetër. Po këtu fusim dhe pasqyrimet e leksemave dhe morfemave ballkanike (për shembull *m'osk'i* em. n. sh. ‘mushkë’ ose *z'asevlok* ‘riti i zënies së brumit para dasme’, ‘dita e parë e dasmës kur kryhet ky rit’; *p'islok* ‘pisë’ nga shq. *pisllëk*), të cilat ndjekin ligjësitë historiko-fonetike sllave. Janë të natyrshme si reflekset e ereve intensive (*š'ija*), ashtu dhe zhvillimi i veçantë në dubletet e vjetra (për shembull *id'in'aeset* ose *k'asno*).

Refleksi i fonemës “jat” kryesisht është ekavian (nëse nuk marrim parasysh ndryshueshmërinë fonetike [e] ~ [ɛ] si në *sen'oto*), por ka forma interesante dublete, që të shpien në pasqyrimin fillimisht të gjerë të tij në [’a] të paktën në një pjesë të leksemave: khs. *izl'egveme*, por dhe *izl'agvaet mom'ičin'ata*; *izl'agveme*; *vl'agvet*. Në përshkrimin e Xhelal Yllit sillen si reflekse të jat- shembujt: *dj'ete*; *mj'esto*; *tj'esno*; *ml'jekoto*, por dhe *ml'akoto* [Ylli, Steinke 2008: 55];⁴² ato hapin, veç të tjerash, çështjen e statusit fonologjik të diftongëve të mundshëm ose të

⁴¹ Përcaktimi metonimik për ditën e Shën Andreas, njihet mirë nga gjuhët joslave të pjesës perëndimore të Ballkanit [МДАБЯ 2005: 18—19] dhe për rumanishten — *îndrea*, *undrea*.

⁴² Gabimisht këtu është futur dhe *tj'ele*.

tiparit të palatalizimit të bashkëtingëlloreve dhe sonanteve. Ka mundësi, që në po këtë kontekst duhet parë edhe kufizimi i pjesshëm distributiv i realizimit të *j*-së nistore para zanoreve të radhës së përparme (*i'esti // 'esti, i'eden // 'eden, 'emiš, por j'ebam*).

Pasqyrimi i *{ rrokjeformuese në një varg shembujsh shpie në drejtim të dublimit [ə] ~ [o]/[ɔ] në afërsi me -r: *cərn // corn; c'ərvena // c'orveno; d'ərva // d'orva, d'orven'i; f'ərlaj // f'orl'it, f'orl'am; t'ərgame // t'orga, t'ornam; v'ərn'it // v'orn'it; v'ərvet // v'orvet; v'ərzime, v'ərveme // v'orzam*. Një sasi e madhe leksemash është fiksuar, prapëseprapë, vetëm me një pasqyrim -or- ose kryesisht me të, duke treguar ligjësinë dhe karakterin tipik pikërisht të këtij refleksi: *n'a corkof, č'orvekot, d'ɔ:rža // dorš!, g'orcija, kərf, snop od 'orš, 'oršta, p'orvi mag'išn'ark'i, p'oržiš, s'orceto, t'orgam, t'orlo, t'ornaf, v'orfca, se v'ortam, sv'orši*. Megjithatë ka dhe një temë, që demonstroi më shpesh -ər- (*t'orbuška.*, por *t'ərbuška.*, *t'ərbuškata; tərb'ufček*).

Pasqyrimi i *{ në mënyrë analogjike dëshmon për funksionalitetin e njëjtë të [ə] ~ [o]/[ɔ] në afërsi me -l: *d'əlg'i; m'əlza, m'əlzi // m'olze.; pəln // p'olnu; vəlk; ž'əlčta // ž'olčta*, por si refleksi i natyrshëm dhe tipik duhet pranuar -ol-: *st'olpot, kolk od j'are, ž'olto*. Zhvillim të veçantë tregojnë leksema *j'abulko // j'abolka*, dubleti i lashtë *gl''itat* v. 3, n. nj. 'kapërdij', dhe me siguri, forma *s'unce*, që, ndoshta, ka depërtuar në të folme nën ndikimin e jashtëm (khs. formën më të rregullt, që pasqyron thjeshtimin e grupeve të sonanteve, — *s'ončl'avo vr'eme*).

Ka të ngjarë që për funksionalitetin e njëjtë të [ə] ~ [o]/[ɔ] në afërsi me -l të flasin dhe rastet sporadike si *plət // plot* 'gardh'; *zd'əlnata v'il'ica* (me ndajfoljen *zd'ola*); këmbime analoge në afërsi me sonante gjejmë për [a]: *p'ərchule; m'əik'i n'aši rab'ote*. Nga detajet e vokalizimit na bie në sy edhe ndryshueshmëria e formave *č'akai!* dhe *č'ekaj!* dhe e rastit të vetëm të *u* protetike: *t'atko mi n'e e u'oden n'a mera*.

Grupet *čr- dhe *č{- kanë dy reflekte të ndryshme, si me č- nistore (*č'erevo, č'ereva, č'erevata, čer'evana* 'zorrë'; *č'er'epn'ite, čerepn'arica; č'orvekot*), ashtu dhe c- nistore (*cərn // corn; n'a corkof; c'ərvena // c'orveno*); ndarja e tyre, ka gjasa, është leksikalizuar. Individual është zhvillimi i grupit parasllavojugor *cv- në *cut, cut'oite* 'lule'.

Një ngjyrim veçanërisht të qartë i jep tingëllimit të ligjërimin në të folmen tonë humbja e -v- intervokalike, që realizohet sipas rregullave vështirësisht të shpjegueshme, ose ruajtja e saj në disa pozicione Janë të qartë shembujt e leksikalizuar të risintezës së temës së formës së shquar të emrave me nyjën -v- *gla:* (nga *gl'ava*), *m'eća:* (nga *m'ećava*), *b'akla* (nga *b'aklava*), që kanë shërbyer për forma të tjera të shquara *gl'a:ta*, *b'aklata* (jo **baklavata*) etj.⁴³ Morfonologjia e kësaj dukurie dhe e dukurive të tjera të ngjashme ende nuk është studiuar, por disa kufizime të humbjes mund të shpjegohen me synimin për të shmangur shfaqjen e radhëve vokalike trigjymtyrëshe (për shembull *prež'iveat*), të tjerë kanë karakter morfologjik më të dukshëm (për shembull synimi për të ruajtur temën e përemrit dëftor 'ov- 'ky' dhe, ka mundësi, të nyjës shquese të një rrënje, si, për shembull, në *trap'oive* n. sh. 'burim'). Është morfologjizuar humbja e -v- në format e n. sh. të emrave njërrrokësh të gjinisë mashkullore të llojit *tr'apoi*. Më poshtë janë sjellë disa shembuj që ilustrjnë arbitraritetin iluziv të humbjes në kushte fonetike identike ose të ngjashme, të tilla si:

i-e: *p'okrien*, por *rog'oive*; *prež'iveat*;

e-i: *k'oše*, por *'orevi*;

e-e: *n'estata*, por *nev'estata*;

e-o: *dr'eo*, por *č'erevo*, *j'arevo*;

e-a: *prež'iveat*, por *z'evame*, *z'evaet*;

a-i: *kuk'aicata*; *n'apraiš*, por *'ubavi*; *pr'avime*;

a-e: *pr'ae:me*, por *pr'ave:t*;

a-a: *dorž'a:ta*, por *d'avam*; *arif'in'ava*;

a-u: *j'avuet*;

o-i: *al'im'oite*, *dail'oite*; *br'egoi*, *rog'oite*, *trap'o:ive*, por *n'ožovi*; *ps'ovisat*;

o-e: *č'oek*, *p'oće*;

o-a: *k'oam*, *k'oat se*, *rasto'ari*, por *k'ovam*;

o-o: *g'otovo*;

u-a: *č'uame*, *kup'uano*, por *p'oduvam*, *b'uvaše*.

⁴³ Shih gjithashtu mbiemrat si *čarven'ika:* (*k'oza*) 'e kuqërremë e errët (dhi)'.

Në tërësi, e folmja të lë përshtypjen e një të folmeje të pasur me kombinime vokalesh dhe gjatësi fonetike të ndryshme në vend të emfazës (për shembull *sl'eze:nka*), të kontraksioneve (për shembull *izgn'i:*; *ne: mn'ogu*; *što će m'u pra:m s'ega*; *gl'a:ta*) dhe të eliminimeve të *-h* (veçanërisht në format e imperfektit si *se v'ikae*, *m'olze:*, *'ide:*; *će i pr'ae:me k'ukurek*; *će i m'iije:me*, *će i j'ade:me*). Po këtu fusim dhe elizionet e leksikalizuara *d*, *g*, *ž*, *m* në leksemat me frekuencë të lartë si: *j'ait*; *kl'ai!*; *će p'oiš*, *poišt*, *oišt*; *s'eit*; *st'uit* // *st'udit*; *tr'ieset*; *k'oa* 'kur', *s'ea* // *s'ega*, *n'ekoa*, *n'ekoaš*; *m'oeme*, *n'e moel*, por: *mož'a:me*; *n'eame*.

H-ja etimologjike ruhet vetëm në leksema të veçanta apelative dhe gjendet vetëm në pozicionin pas zanores së radhës së prapme *u* (*p'azuha*), ndërkohë që është fakultative në emrat e përveçëm orientalë si *'ibrahim* // *'ibraim*, po ashtu në pasthirrat dhe pjesëzat si *hm:* 'hm'; *ha* // *hə* 'po'; *he:* 'ej'; *ah'a:* 'aha'. Përveç humbjes së *h*-së (për shembull në *'odi!*; *gr'eota*; *zd'iot*; *sirom'aište:*; në emrin e përveçëm *'asan* etj.) janë të zakonshme dhe zëvendësimet e saj: *k'ažavme*; *'orevi*; *straf*; *m'ara graf*, po ashtu *m'ara ot gr'aq*; *'orei* // *'oref* (në formën *'ores* 'arrë' është përgjithësuar rezultati i palatalizimit nga forma e numrit shumësh); *r'avmet da si 'imaet!*; *'avmet*.

Inventari i sonanteve dhe i konsonanteve të së folmes është tipik i maqedonishtes perëndimore. Statusi i saktë i tingujve [j], [j̥], [l'], [l̥], [n'], [n̥], [k'], [k̥], [č], [g'], [g̥], [ʒ] dhe [ɣ] mund të përcaktohet vetëm pas studimeve të posaçme të artikulimit dhe akustikës së tyre si dhe të analizës fonologjike. Rregullat e kombinimit të fonemave bashkëtingëllore (konsonante dhe sonante) në të folme shpesh janë individuale dhe i japin tingëllimit të saj një ngjyrim të qartë lokal. Krahas me metatezat dhe anticipimet e palatalizimit të përhapura gjerësisht (të tilla si *n'otk'i* / *n'oftk'i* n. sh. 'thonjtë'; *gr'oize* 'rrush', *gr'oizer* 'shtator'; *k'on'ot* // *k'oijn'ot*; *m'okaj'n'e* // *m'očaj'n'e* etj.) janë vërejtur thjeshtëzime dhe zgjerime të grupeve, asimilime dhe disimilime sipas vendit dhe mënyrës së formimit:

grupi *hv-* > *f-*: *f'ati*;

grupi *-dn-* > *-n-*: *'ena* po *'ena*; *z'aeno*; *'ispan'it*, *p'anala*; *on'esiš*, *on'esime*, por *'edno*; *'ispadna*; *s'edn'i!*; ndërkohë *ž'adna*; *ž'adn'ica*, siç duket, vetëm me *-dn-* nën veprimin e afrikates nistore;

grupi *str-* dhe *zdr-* ruhen: *straf*; *zdr'avije*; ndërkohë që grupi *sr-* zgjerohet në *str-*: *mi e stram da k'ažam*; *ž'ivo str'ebro*; *da go str'abotaš*;
grupi *-(m/n)stv-* mund të thjeshtëzohet: *k'umstvo // k'umsto (k'umstoto se j'ait)*; *peliv'ansto*;

grupi *-sk-* zakonisht ruhet (*sk'osime*; *d'eneska*) me përjashtim të pozicionit pas sonantes, ku *-s-* bëhet si mbylltore *-k-* (*person'alck'i*, *s'elck'i*; *b'ugarcko*, *p'azarcko*, *t'urcko*; *kl'omcka*; *albanck'i*, *kristij'ancko*, *mak'ed'oncko*, *st'ancko*, *ž'enck'i*); khs., megjithatë dhe format *s'elsk'i*; *t'ursk'ive*; *v'orska*; *albansk'i*; *r'amaz'ansk'i*; *ž'ensko*; khs. gjithashtu *-tsk-* > *-ck-* *arna'ucko*;

grupi *-db-* pëson metatezë dhe disimilim në *vd-*: *sv'avda*;

grupi *kv-* > *kl-*: *kl'aseno*, por khs. *t'akvi*; *n'ikakva*; *se: ž'd'ukvelo*;

grupi *cv-* > *sv-*: *sv'ečín'a // cv'ečín'a*;

grupi *mn-* > *ml-*: *t'oe se v'ardit ml'ogu kaj n'ami*; por khs. gjithashtu dhe *mn'ogu*; *t'emna*;

grupi *vn-* > *mn-*: *l'istomn'ik*, *g'uvno // g'umno*, po ashtu *g'umnar*; *r'amn'ina*;

grupi *sc* > *fc*, *zč* > *fč*, *žč/šč* > *fč*: *go r'afcepa*; *ž'elefče*; *gr'adečfe*; *š'oška* > *š'ofče*; ndoshta, këtu duhet futur dhe shembulli *t'arb'ufček* me zëvendësimin e *h-*së historike.

Opozicioni sipas palatalizimit ashtu si pritët karakterizon sonantet (*sol'*; *k'onče* 'gjalme' dhe *k'on'če* 'kalë'). Nuk vihet re përzjerje afrikatesh, po ashtu dhe mënjanim i plotë i tyre nga inventari (*n'ozine*; *n'ogata ž'adna*; *m'alzi*; po ashtu *v'əržvai*; *žv'iska // zv'iska*; *ž'izdar // z'idar*). Janë realizuar jotizime të reja (*br'aća*; *pr'uće*; *l'uže // l'ug'e*).

Opozicioni sipas shurdhësisë ~ zëshmërisë neutralizohet jo vetëm në mënyrën tipike (*goš* ~ *g'ožon 'esti p'okrien so 'opaš*), por edhe në pozicionin para sonanteve (*pomožn'ici*; *za da se zb'erid ml'ekoto*; *od 'ofcite*, *što 'imaed r'odeno*). Ndeshen dhe raste të reflekseve të lëvizshme të tingujve të reduktuar (*k'e zn'aeme m'ie odo što b'eše?*).

Asimilimi progresiv sipas shurdhësisë *pv*, *tv*, *sv*, *kv* > *pf*, *tf*, *sf*, *kf* është vënë re në shembujt *šfarime*, *sve // šfeko*; *se r'asifet*, *k'upfe:d*;

na bor'oica t'ikfi v'arime; i t'ikfi ça s'farime; t'akfa z'elena 'esti; 'otforiš (por sv'orši) dhe ka të ngjarë që dëshmon prirjen e ngushtimit të distribucionit të v-së dhe forcimit të statusit të saj konsonantik. Dukurinë e kundërt mund ta shohim në brau (braf, br'avot) dhe graf // gr'ao.

Shumica e këtyre proceseve nuk është karakteristike për të folmet shqipe të rajonit. Ndikimi i të folmeve shqipe gege ose i gjuhës letrare shqipe mund të shihet në zgjerimin e inventarit të fonemave për shkak të njësisive të përdorura në leksemat e huazuara (për shembull /q:/, /y/, /ð/: n'q:na m'oja 'imat k'ažveno; b'yreci; 'ak'i i 'ak'i mi nd'ođe). Në tërësi, duket se në rrafshin e fonetikës dhe fonologjisë të së folmes (inventari i tingujve, inventari i fonemave, rregullat e shpërndarjes të tyre në leksikon me prejardhje sllave ose në leksikon e huaj të integruar), nuk para bien në sy gjurmë të zhvillimit konvergjent në ligjërimin e të anketuarve kompetentë dhe kjo shihet mirë, në veçanti, në tekstet e transkriptuara, të publikuara në shtojcë.

Morfologjia dhe morfosintaksa. Kategoria e rasës së emrit është e reduktuar deri në minimumin tipik për të folmet e maqedonishtes perëndimore. Ndërkohë që zotëruese është forma *casus generalis* për të gjithë tipat e emrave në të tëra rolet sintaksore, emrat vetjakë (vetëkuptohet njëkohësisht dhe frymorë) në numrin njëjës kanë dhe formën *casus obliquus*, të cilën në materialin tonë e kemi hasur me parafjalë (*kej l'ul'zima*, 'ademof; p'išano mu e od g'ospoda; 'ode: se m'ol'e: na g'ospoda t'amu). Duke u gjendur në funksionin e objektit të drejtë, emrat frymorë ndonjëherë shoqërohen nga parafjala na (a t'a: gu 'iskara na mart "Kurse ajo shau marsin"; 'imat d'el'veno na d'ešī⁴⁴ "Ata ndanë deshtë"; khs. 'idet da pl'ašat

⁴⁴ Huazimi leksikor shqip *daš* < *dash* n. nj., *desh* n. sh., siç e shohim, është integruar në të folmen tonë me apofoninë e morfemës rrënjore në n.sh, tipike për morfologjinë e gjuhës shqipe; në këtë mënyrë përveç formës n. nj. *daš* ka lindur dhe forma e kontaminuar e n. sh. *deš*-i. Disa huazime në të folme ruajnë fonetikën dhe format gramatikore shqipe, për shembull n. sh. si *bektašij'ane*.

na žag'urin'a⁴⁵ [Ylli, Steinke 2008: 34; Sobolev 2008]). Me fleksionet e veçanta të numrit njëjës (-u dhe -oe) shënohet rása e objektit të zhdrejtë, të shprehur me emër të përveçëm të gjinisë mashkullore (p'or^dn'i mu 'april'u na br'adina!; p'ordn'i mu 'april'u na br'adina. — m'artoe. — 'ovomu m'artoe); por në përgjithësi në këtë funksion është i rëndomtë konstruksioni ballkanosllav me parafjalën na (na sv'ekoĭ ĉ'oveg go v'arzveme; i im d'avame na 'ofcite so sol'; k'ošla d'oma im k'ažala p'osle ta: na l''udite r'ekla). Kështu, kjo parafjalë është gramatikalizuar për dy role qendrore sintaksore: atë të objektit të drejtë dhe të zhdrejtë. Me sa duket, është fiksuar forma e ngurosor e lokativit në n. nj. gj. m. (mu se kl'apilo f s'one). Rása josintaksore vokativi ka treguesit -o dhe -e, që përdoren si në gjininë mashkullore (l''ul'o:! nga emri i përveçëm shqiptar Lulëzim; aĭde, v'el'it, s'inko, aĭde...; br'atučedo!, por dhe br'atučet!, edhe što ja znam bre, brat!; 'april'e r'il'e, z'aĭmi me tr'in'i, ĉe ti znam za tri god'in'i! e, g'ospode, dai mi en š'in'ig gl'ava! s'e:di, ĉ'il'e!), po kështu dhe në gjininë femërore ('ori n'evesto; s'evdo g'olema!; 'ori vr'anō p'alava; dai, m'amo, ja da ti k'ažam! k'umice, l''isice; o ž'ule! nga emri i përveçëm *Xhulia, Xhuljeta*). Kur i drejtohen dikujt përdorin m'ore! // m'ori! dhe 'ore! // ori! (një gruaje — m'ore, k'ede ĩe m'otkata?; k'umice, 'ori l''isice!; një burri — fati o m'ore!; 'ore!); gruaje mund t'i drejtohet një burri më të ri në moshë duke përdorur mbiemra pronorë të gj. as. të substantivuar m'aĭk'ino! (khs. shq. *o, bir i nënës!*).

Nënvizojmë se sintagmat sllave me parafjalën *od* kryejnë plotësisht të njëjtin funksion si ato shqipe me gjinoren e paranyjzuar (zm'ija od voden''icata; 'ibraim brat od n'ezir; saĭb'ijata ot k'on'ot; saĭb'ijata od voden''ica'a; s'aĭbija od zm'ijata; d'enot ot bor'oica; v'ečerta ot k'adar (nata e kadrit); st'a'lo od 'ofcite, klet ot 'ofcite; cut'oĭte od j'abolka; kolk od j'are, n'osal'kata ot gl'a:na, pod'o:lo ot br'avot, l''ušpa ot kromit; snop od orš; ĉ'eskata ot m'okaj'n'e // ot m'očaj'n'e).

⁴⁵ Në f. 34 të punimit të Yllit ky shembull është përdorur pa lidhje për të demonstruar gjoja “gabimet” që kanë vend në ligjërimin e banorëve sllavë të Gollobordës.

Kategoria e numrit të emrave realizohet nëpërmjet kundërvënies së formave të numrit njëjës, numrit shumës, formave të paukalit (shumësit “të vogël”) dhe formave kolektive, dhe kjo ndodh jo njëjloj në klasa të ndryshme gramatikore dhe në klasa leksiko-gramatikore fjalësh. Sipas rregullave të njohura morfonologjike sllave, emrat e gjinisë mashkullore në numrin shumës kanë fleksione (*k'on'i*, *ovn'i*, *n'a corkof k'auri!*; *oži i p'opoi*; *a tri p'lesoi dr'ug'i p'odel'vet po sirom'aji*; *k'oše*, *l'eb'oitē*, *'orei*, *rog'oitē*) ose forma supletive (*l'uže* // (*umren'i*) *l'udi* // *l'udiē*), ndërkaq, para së gjithash format me *-oi* dhe *-ei*, i japin tingëllimit të së folmes ngjyrim të veçantë. Është vënë re raporti *k'amen* ~ *k'amen'a*. Forma e kontaminuar shqiptaro-sllave e numrit shumës *deš-i* ‘deshtë’, është e vetme.

Paukali (shumësi “i vogël”) është dëshmuar sikurse dhe pritej për emrat e gjinisë mashkullore (*dva sm'oka*; *na dv'ate d'enā*; *dva k'on'a*; por khs. *dva sa:t*; *imaet po pet šez br'ai s'alte*, si dhe *mn'ogu p'o:ti*), megjithëse ka shembuj shkeljesh në përdorimin e tij (*teĭ na'oždaše 'one dve ž'ivin'a spl'eten'i dve ž'ivin'ε dve sm'okoi*).

Mbaresa standarde e n. sh. gj. f. është *-i* (*tri god'in'i*, *k'obl'ici*, *t'orl'ark'i*, *ž'en'ite*), duke përfshirë dhe format e vjetra duale, të rënduara edhe me morfonologjinë parasllave (*n'ožine n'aprežn'i*, *'ovie n'ozi*; *go d'eram s'o roci*); megjithatë, takohet dhe fleksioni *-e* (*žinaj'ak'e*, *ž'adik'iē*; *sapun'oice*).

Për analogji me formën e n. sh. (të dualit historik) është formuar trajta e n. nj. *'uše* ‘vesh’. Mbaresat standarde të n. sh. gj. as. janë *-a* (*j'aganā*; *s'iren'a*; *m'esā*; khs. gjithashtu *r'ebro* ~ *r'ebja*), *-išta* (*jar'ištava*; *k'učišta*), *-ina* (*iogl'enčina*) dhe *-in'a* (*'imin'a*; *ar'ifin'a*; *j'arin'a*; *žagur'in'ata*; *m'odin'a*; po kështu edhe *sv'ečin'a* // *cv'ečin'a*), ndërsa kjo e fundit është përgjithësuar në mënyrë shumë të veçantë për emrat që mbarojnë me *-če* në n. nj. (*k'atčin'a*; *kuč'in'ata*; *l'ekčin'a*; *polozn'ičin'a*; *rokč'in'ata*; *top'ančin'a*; *z'opčin'a*). Çështja e statusit variativ ose të dubluar të formave si *j'arišta* ~ *j'arin'a* mbetet ende e hapur.

Në të folme ekzistojnë format e singulativëve të gjinisë mashkullore dhe asnjane si *k'aurin* ~ *k'aurē* (e para me kuptim neutral, e dyta me

kuptim zvogëlues ose përbuzës), secila me shumësin e vet: *k'auri* ~ *ka'urin'a* (*n'ekoe ot ka'urin'ε b'eše?*). Në mënyrë analogjike forma e gj. f. n. nj. neutrale për nga kuptimi *n'oga* i kundërvihet formës zvogëluese të gj. as. n. nj. *n'oze* (*s'ega će o kr'ena m'alo za da mu t'orna 'enono n'oze*). Në këtë të folme ekzistojnë gjithashtu forma të n. sh. gj. f. dhe forma kolektive të gj. as. si *n'ozi* ~ *n'oze*, *n'ozeto*; këto të fundit, siç duket, në një sërë rastesh janë përgjithësuar në rolin e numrit shumë standard (*pret os'umdesed g'odin 'e; gr'ežeto; n'ivijeto; l'ošir'aboči; k'el'iv'ag'eto maks'udoi*); e njëjta gjë, ndoshta, ka vend edhe në formën e gj. as. *vr'aće* 'dyer'. Emrat e n. nj. me semantikë "plurale" përshtaten dhe bashkohen me kallëzuesin në të folme në n. sh.: *n i rab'otae n'arodot, 'ode; v g'orcija*. Në përgjithësi mund të themi se çështja e ndërveprimit të kategorive të shumësit, përmblendshmërisë dhe zvogëlueshmërisë, është një nga çështjet më tërheqëse për studiuesit e ardhshëm.

Në rrafshin e kategorisë së gjinisë kemi konstatuar përshtatjen e emrave të tipit *h'oža* 'hoxhë, imam', *ć'aja* 'pronar i një numri të madh dhensh; qehaja' me atributin në gj. f. (*na 'edna h'oža; ć'aja g'ol'ema*). Ndeshen edhe emra të gjinisë femërore të tipit *klet, loi, var, žalč* (*će r'odit t'uka vo kl'etta; 'imat loi, 'eve, 'ene 'onamu e b'elana; s'amo ć'ista var mu kl'avam, samo ć'ista v'arta; žalčta ja m'etname*).

Morfologjia e nyjës shquese del në të folme ashtu si pritej (*n'ožot, zd'iot; st'olof; č'enkata, m'asna, 'ofcine; bel ž'ig'er ~ b'el'iod ž'ig'er*), duke demonstruar disa shmangie vetëm në huazimet shqipe (*bab'ai // b'abaiā n'eizin 'ošol vod'en'ici*). Nyja e pashquar mund të funksionojë si përforcues i kuptimit të emrit (*'ena m'ēca; 'ena f'ortuna!*), ka formën e n. sh. (*za 'en'i st'ari, za 'en'i st'ari na s'eloto... i t'ije b'ile ž'adi: t'ešk'i; će i z'alezit pod 'eni b'uk'i*), kur përputhet me përemrin e papërcaktuar (*se d'elvet po sirom'aite... napr'imer vo s'elovo zn'aime m'ie 'en'i n'emaed br'ai; i će se ft'urit na 'ofcite, i će a f'atit 'ena*), ndërsa me emra që tregojnë lëndë, jep kuptimin e një pjese të lëndës (*daj 'edna v'oda da se n'apija!*).

Nga format e plota të përemrave vetorë vlen të përmendim rasën e subjektit v. 1, n. sh. *m'ie*,⁴⁶ rasën e objektit të zhdrejtë të tipit *v'ami* (i *v'ami* da *vi d'adid g'ospot!* “Dhe juve zoti ju dhëntë!”), rasën e objektit të drejtë të tipit *n'ami* (*sl'ikai ne nami!* “Fotografona ne!”), si dhe mënyrën e rasës parafjalore të shprehjes së objektit të drejtë (*t'ie n'i pr'enovet* (nga shq. *pranoj*) i *z'emja na n'imi* “Ata dhe dheu nuk i pranon”). Ka të ngjarë që format e tipit *nam* dhe *n'ami* dëshmojnë për kontaminimin e formave të rasave të objektit të drejtë dhe të zhdrejtë me formën e rasës instrumentale ose formën e përgjithësuar të rasës me parafjalë.⁴⁷ Po japim disa shembuj të formave rasore me parafjalë të përemrave: *k'e n'ami*; *t'oe se v'ardit ml'ogu kai n'ami*; *k'ai nam n'ema t'akvi*; *t'ie sm'okoi, da im m'etn'is n'ešto nad n'im*.

Inventari i klitikave, nga njëra anë, është plot me forma që i kundërvihen qartësisht njëra-tjetrës për nga gjinia dhe numri (kallz. n. nj. gj. m. *çe o v'orzam // çe go t'ornam*; kallz. n. nj. gj. f. i *zm'ijata ja 'utepa*; dhan. n. nj. gj. m. *mu n'osam n'emu t'amo*; dhan. n. nj. gj. f. *ne mož n'išto da i n'apraiš*; dhan. n. sh. *im d'avam č'enka*; i *im d'avame na 'ofcite so sol'*; kallz. n. sh. *do kež 'ašiko n'i i t'ərgame n'ozite*), por nga ana tjetër, në shpërndarjen e tyre bie në sy ndikimi i pritshëm i gjuhës shqipe, i cili konsiston pikërisht në mosdallimin e gjinisë dhe numrit të një sërë klitikash (*ajd, v'el'id, da a z'emam p'uškava da go 'utepam zm'ijata*).

Përemri frymor pyetës-lidhor dhe përemrat dëftorë kanë forma të dhanores për funksionin e objektit të zhdrejtë (i *k'omu çe mu p'an'it l'ekot, toj go mal k'ismetot v'el'ime*; *p'ordn'i mu 'april'u na br'adina — m'artoe. — 'ovomu m'artoe*); në po atë funksion takohet dhe forma e kontaminuar *na + dhan.* (*na k'omu çe mu p'an'it l'ekčeto, toj k'ismetl'ijata*).

⁴⁶ Është i përhapur gjerësisht mendimi se për shkak të këtij përemri një pjesë e popullsisë maqedonishtfolëse në rajonin e Dibrës ka marrë ekzonimin *Mujaujume / Mijacite*.

⁴⁷ Dukuri të ngjashme me këtë vihet re në disa të folme shqipe, ku forma e dhanores është përgjithësuar për sektorë të tjerë të paradigmes, *p.sh. n'eve (= ne) jet'ojm në l'eshnje; 'ishte hysmeq'ar kët'u tek j'uve (= ju)* [Юллы, Соболев 2002: 80—81].

Sjellim akoma disa të dhëna jo të plota për disa forma përemrash dhe mbiemrash përemërorë: dëftorë (gj. m. dhe gj. f. n. nj. 'ovoe tin, 'ovaia m'otka), mohues ('asnjëherë': i 'oko n'e faštaš n'ikoj pot), pyetës ('i kujt': 'ove j'ajce č'ivo e? 'ove 'esti 'asanovo, 'ove č'ivē? ramaz'anovo), të pacaktuar ('çfarëdo që të jetë; ç'të duash': što b'ilo // l'ep, l'epče m'ara, što da b'ilo; 'kushdo qoftë': koj b'ide), përgjithësues ('të gjithë': se // sve; ja pr'ave:t sv'ešte n'ešte; za d'enot ot bor'oica k'e si napr'aime sv'ešte n'ešte, m'eso, j'aden'e, p'ien'e; 'kushdo, secili': sf'ekoј braf). Interesantë janë përemrat pronorë, të formuar mbi bazën e dëftorëve (i s'ea t'ie se tri d'ena apr'il'oј što v'orn'it ovog'oј od mart, apr'il'oј, 'ama mart i z'evat; ž'enata ov'ogova); në përgjithësi për përemrat pronorë, siç duket, është karakteristike vendosja e tyre pas sendit të përcaktuar (sipas tipit m'estovo n'a:še; khs. dajxho ot moža mi moj; babaj mu negof; babaj mu ovogof; stari babaj ovojzin [Ylli, Steinke 2008: 35, 97, 102]). Në kuptimin 'njëri — tjetër' është konstatuar: 'ena mu t'ornaf i 'ova dr'uga. Në kuptimin përgjithësues vetjak përdoret përemri vector v. 2, n. nj. (na sv'ekoј č'oveg go v'arzveme, pol'oinata da ne te b'ol'i za c'ela g'odina) dhe leksema me kuptim të plotë č'oek 'njeri' (a dr'ug'ite, t'arb'uškava i 'ovie, da i z'amiet č'oek, se j'adat).

Kategoria e shkallës së krahasimit përveç formave të zakonshme përfshin dhe krahasoren e përbërë të mbiemrave dhe ndajfoljeve (p'oveće 'arno ja j'adet; p'oveće č'isto 'esti, n'e faštat č'orvekot), si dhe ka shtrirë treguesit e saj në trajtat e kryera të foljes (a da im ja for'l'iš so sv'e dorvo, po: ne m'oad da j'ade:t br'aite).⁴⁸ Në konstruksionin sintaksor të krahasimit njësia e tij futet pa parafjalë: 'ibrahim je po star od mene č'etiri g'odin'i.

Nga morfologjia dhe morfosintaksa e foljes vlen të përmenden:

format e foljes 'jam' (v. 1, n. nj. su // sum; v. 2, n. sh. sve; zdr'avo sve! zdr'asve!; v. 3, n. nj. 'esti // et; 'ista et mas);

format mohuese të foljeve 'dua' (v. 1, n. nj. n'eća) dhe 'kam' (v. 3, n. nj.: go č'istam so n'ožod da n 'ima n'ekoe k'amče; s'ea n 'imaed rab'otano ne se rab'ota:n'i n'ivjēno);

⁴⁸ Khs. n'e para kup'uaet "Nuk para blejnë".